| Resistenca shperndarjes se shpejte te carjeve, per tubacionet SDR 11, D=250mm                      | Stopimi                                   | Temp. e testit<br>Metoda e testit<br>Pres. Brendshem<br>PE80<br>PE100               | 0 °C<br>Ajer<br><br>8.0 bar<br>10.0 bar                    | ISO<br>13477:1997<br>(testi S4)   | > 12 bar                       |
| Norma EN 12201-2                                                                                   |                                           |                                                                                     |                                                            |                                   | Euro<br>PE 100<br>E zhvillimit |
| Karakteristikat Fizike                                                                             |                                           |                                                                                     |                                                            |                                   |                                |
| Karakteristikat                                                                                    | Kerkesat                                  | Parametrat e testit                                                                 |                                                            | Metoda Testit                     |                                |
|                                                                                                    |                                           | Parametrat                                                                          | Vlerat                                                     |                                   |                                |
| Zgjatja ne thyerje                                                                                 | ≥350%                                     | Ne perputhje me tabelen 5 te EN 1220-2                                              |                                                            | ISO6259-1;2001 and ISO6259-3;1997 | > 500%                         |
| MFR (Treguesi i rrjedhshmerise) PE63-PE80-PE100                                                    | Ndryshimi MFR ne vazhdimine punimeve ±20% | Ngarkesa                                                                            | 3 kg                                                       | ISO 1133;1999<br>Kushti T         | 0.30                           |
|                                                                                                    |                                           | Temperatura                                                                         | 190 °C                                                     |                                   |                                |
|                                                                                                    |                                           | Koha                                                                                | 10 min                                                     |                                   |                                |
|                                                                                                    |                                           | Nr. l eneve                                                                         | 3                                                          |                                   |                                |

<sup>1</sup> In conformity of these requirements should be demonstrated by producer of the compound

<sup>2</sup> In conformity of these requirements should be demonstrated by producer of the compound

|                                    |          |                            |             |        |          |
|------------------------------------|----------|----------------------------|-------------|--------|----------|
| Koha e induksionit<br>te oksidimit | ≥ 20 min | Temp.testit<br>Numri eneve | 200<br>3 °C | EN 728 | > 20 min |
|------------------------------------|----------|----------------------------|-------------|--------|----------|

#### 7.1.4 SHENJA/NGJYRA E TUBACIONEVE

Materiali i tubit do jete me nje ngjyre zeze per shkak te pigmentit me karbon te zi te lendes se pare. Tubi per transport uji do te jete i dallueshem nga klasifikimi i lendes se pare blu.

Shenja, e kryer sipas specifikimeve te standartit, do jete e pranishme ne cdo meter tubi dhe do raportoje:

- 1- Emri ose marka e procesorit dhe lendes se pare
- 2- Diametri jashtem i tubacionit dhe trashesia/spesori (shprehur ne in mm)
- 3- Serite SDR
- 4- Materiali dhe percaktimi
- 5- Klasa e presionit
- 6- Kodi i percaktimit te prodhimit te procesorit
- 7- Rregulloret perkatese per prodhimit
- 8- Kodi IIP i materialit te lendes se pare tecertifikuar

#### 7.1.5 PRANIMI

Para pranimit te cdo partie furnizimi, Supervizori ka mundesine te paraqese tubacionin per testime ne perputhje me EN 12201 ne laboratorin e kompanise furnizuese ose laborete te tjera te kualifikuara e te njohura zyrtarisht (IIP laboratorit ose laborete te certifikuar sipas Standarteve te Serive ISO 45000). Gjithashtu Supervizori ka te drejte te marre certifikatat te referuara ne Piken 3 te specifikimeve aktuale, lidhur me Materialin e Lendes se Pare te perdorur ne prodhimin e tubit, duke verifikuar perdorimin efektiv permes dokumentave lidhur me gjurmueshmerine e procedurave te miratuara nga kompania e prodhimit te tubit.

Supervizori, gjithashtu ruan te drejten te marre dokumentat qe sigurojne pronesine e Certifikimit e Sistemit te Cilesise se Perbashket (CQS) mbi bazen e Standartit UNI EN ISO 9002. Per qellime pranimi, do te konsiderohen per tu vertetuar cdo diameter ose parti deri ne nje shume ose me pak, te ndryshme nga diametrat si tregohet me poshte:

RANGU I DIMENSIONEVE TE DIAMETRAVE TE GRUPIT:

- Ø < DN110 5,000 m ose me pak;

- DN110 < Ø < DN315      2,000 m ose me pak;
- Ø > DN315      1,000 m ose me pak

## **7.2 PROCEDURA PER MONTIMIN DHE SALDIMIN E HDPE “PE 100” ME MJET SALDIMI TE NXEHUR**

Procedura e poshtme e dizajnit eshte ne perputhje me standartin UNI 10520 dhe “rekomandimi per saldimin e tubacionit PE100” SMP 74/97.

### **7.2.1 QELLIMI DHE FUSHEVEPRIMI**

Specifikimi prezent vlen per procesin e saldimit me mjet saldimi te nxehte per realizimin e bashkimeve koke me koke te tubave prej polietileni dhe/ose rakorderive per transportin e gazit djeges, ujit, dhe lengjeve te tjera te presuara.

Jane percaktuar gjithashtu procedurat per pergatitjen dhe ekzekutimin e saldimit, kerkesat te jene te kenaqura me paisjet e perdorura, si dhe me tipet e kontrollit qe mund te ndermerren per te verifikuar cilesine e bashkimit ne fund te punimeve te saldimit.

### **7.2.2 RREGULLORET PERKATESE**

pr EN12201 - Pjesa 2 Tubacione polietileni te dendesise se Larte per percueshmerine e lengjeve te presuara - Tipet, dimensionet, dhe kerkesat

pr EN12201 - Pjesa 3 Rakorderite prej Polietileni

pr EN1555 Tubat prej Polietileni (PE) per percueshmerine nen toke per shperndarjen e gazit djeges.

UNI 9737 – Klasifikimi dhe kualifikimi i saldatoreve per materialet plastike – Saldatoret qe operojne me mjet saldimi te nxehte, me paisje mekanike dhe me elektro fusion per tubacionin e nje trashesie nga 3 deri 37 mm dhe me diameter te jashtem me pak se ose te barabarte me 630 mm prej polietileni per transportimin e gazit djeges.

UNI 10565 – Mjeti i saldimit me nxehte te perdorura nga saldatorët e terrenit te ndertimit per ekzekutimin e bashkimeve koke/koke te tubave prej polietileni dhe/ose rakorderive, per transportin e gazit, ujit, dhe lengjeve te tjera te presuara.

UNI 10520 Procesi i saldimit te bashkimeve koke me koke me mjetin e saldimit te nxehte te tubave prej polietileni dhe/ose rakorderive per transportin e gazit, ujit, dhe lengjeve te tjera te presuara.

WIS 4-32-08 Specifikimi per bashkimin me fuzion ne terren te tubit PE80 dhe PE100 dhe rakorderive.

---



### 7.2.3 LISTA E SIMBOLEVE

s: trashesia e tubit ose rakorderise, ne mm;

T: temperature e elementit termik, ne °C;

P<sub>1</sub>, P<sub>2</sub>, P<sub>5</sub>: presionet per aplikim gjate fazave 1, 2, 5 te ciklit te saldimit, ne N/mm<sup>2</sup>;

P<sub>t</sub>: pengese presioni, ne N/mm<sup>2</sup>;

t<sub>1</sub>-t<sub>5</sub>: afati kohor i fazave 1-5 te ciklit te saldimit;

t<sub>6</sub>: koha e ftohjes, ne min.

A: gjeresia e cdo dy kordoneve formuar gjate fazes 1 te ciklit te saldimit, ne mm;

B: gjeresia finale e tegelit te saldimit, ne mm;

b<sub>1</sub>, b<sub>2</sub>: gjeresia e dy kordoneve qe perbejne gjeresine totale te tegelit B, ne mm.

### 7.2.4 PARIMI I METODEDES

Mjeti i saldimit te nxehte eshte percaktuar per krijimin e nje lidhje te dy elementeve (tubash dhe/ose rakorderish) te trashesise se barabarte ne te cilen siperfaqet per tu salduar jane te nxehura fillimisht deri sa fuzioni ose butesia nga kontakti me nje element te nxehte (element termik) dhe pastaj, pas heqjes se tij, jane te bashkuara permes presionit per te perfitur ngjitjen.

### 7.2.5 MATERIALI BAZE

Kerkesat ne kete standart jane te zbatueshme per saldimin e tubave prej polietileni te klasifikuar sipas EN 12201 pjesa 2 dhe rakorderive te klasifikuar sipas pjeses 3. Rreshirat e perdorura per prodhimin e tubave dhe/ose rakorderive duhet te jene te njejt tip, ose, nese i ndryshem, duhet provuar perputhshmeria me saldimin.

### 7.2.6 PAISJA E SALDIMIT

Saldimi duhet te kryhet nga saldatore te specializuar dhe te afte, paisur plotesisht me:

- Nje njesi kontrolli te komanduar per bashkimin mekanik te skajeve per tu salduar, me nje mates presioni ten je klase te pershtatshme per kontrollin e presionit te aplikuar;
  - baze qe perbehet nga dy mbeshketes, nje e fiksuar dhe nje levizeshme, e cila mund te ulet mbi drejtuesen, secila e paisur me dy nofullat per mbylljen e pjeseve per tu salduar;
  - element termik pjate mbuluar me nje material anti pasues, me rezistence elektrike inkorporuar dhe rregulluar nga nje thermostat i kalibruar;
  - makineri freze e afte per te siguruar pregatitjen e drejte te skajeve.
-

- Sistemi per kontrollin automatic te operacioneve te saldimit permes:
  - komande hidraulike e elementeve shtyrese dhe pjates salduese
  - manaxhimi i vlerave te presionit te caktuar per fazat e ndryshme
  - manaxhimi i koheve te caktuara per fazat e ndryshme
  - manaxhimi i temperaturave te caktuara
  - regjistrimi dhe rikthimi i parametrave te perdorur per cdo bashkim te vetem dhe numerimi i tyre progresive mbi mjet manjetike ose leter

#### 7.2.7 TIPARET

Paisja e perdorur duhet te garantoje:

- shtrirjen e sakte te copave per tu salduar;
- paralelizmin e sakte te siperfaqeve per tu salduar;
- rregullimi dhe kontrolli i parametrave te saldimit (presioni, temperatura, koha);
- perputhja me rregulloret legjislative ne fuqi.

#### 7.2.8 PAISJET

Aparati i saldimit/Saldatori dhe paisjet e tjera te nevojshme (elementi termik, routeri) duhet te garantojne qe procesi i saldimit eshte kryer ne menyre te kenaqshme qe eshte ne perputhje me procedurat e pershkruara ne paragrafet ne vijim.

Ne vecanti, eshte e rekomandueshme qe kerkesat e meposhtme te jene arritur kenaqshem.

#### 7.2.9 ELEMENTI-TERMIK

Energjia elektrike e elementit termik duhet te jete e mjaftueshme per te garantuar arritjen e temperaturave te kerkuara nga kushtet e pranuar te punes; gjithashtu ajo duhet te siguroje qe temperatura nuk vuan nga variacine te medha  $\pm 5$  °C ne lidhje me vlerat e vendosuar ne termostat ne cdo pike te dy siperfaqeve te elementit termik.

Elementi termik duhet te paiset me nje termometer me nje game matjesh te pershtatshme per temperaturat e vendosura.

Kur nuk eshte ne perdorim, elementi termik duhet te vendoset ne nje kontenier ene te pershtatshme, karakteristikat e te cilit duhet te jene te tilla qe te mos provokojne demtim ne mbulesen siperfaqesore te elemntit termik.

---

### 7.2.10 INSTRUMENTALIZIMI

Instrumentalizimi i saldimit/aparatit te saldimit duhet te perbehet nga:

- Nje mates presioni me nje rang matjesh dhe dimensionesh qe mund te lejojne zbulimin e ndryshimeve ne presion te pakten 1 bar;
- nje sahat me njoftim tingulli per sinjalizimin e koheve te ngrohjes;
- nje sahat me njoftim tingulli per sinjalizimin e koheve te saldimit;

saldatori/aparati i saldimit duhet te shoqerohet nga informacionet qe vijojne:

- karakteristikat e vajrave te perdorur per furnizimin e qarkut komandues, ne vecanti te viskozitetit te tyre;
- fuqia maksmale e thithjes nga aparati i saldimit;
- seksioni i cilindrit shtytes te qarkut komandues.

### 7.2.11 MAKINERIA FREZE

Motori i makinerise freze duhet te kete fuqine fuqine e duhur per rangun e punimeve te saldimit.

Aktivizimi i saldimit duhet te jete i mundur vetem pas futjes se saj ne pozicionin e punes.

### 7.2.12 KUSHTET MJEDISORE

Ekzekutimi i saldimit mund te kryhet ne nje vend te thate nese eshte e mundur: ne rastin e shirave, niveleve te larta te lageshtires, eres, ose rrezatimit diellor te tepruar, zona e saldimit duhet mbrojtur ne menyre adekuate me perde te pershtatshme; eshte ne cdo rast e keshillueshme per te performuar saldimin ne nje rang te temperatures se ambientit ndermjet -5 °C dhe +40 °C.

Nuk eshte e lejuar perdorimi i pishtareve te nxehte gazi ose te djegesave ne kontakt te drejteperdrejte me siperfaqet per tu salduar per te rritur temperaturen e tyre.

## 7.3 KONTROLLET PARA OPERIMEVE TE SALDIMIT

### 7.3.1 KONTROLLI I MATERIALEVE

Para fillimit te operacioneve te saldimit duhet kryer nje ekzaminim vizual dhe dimensional i materialeve per tu salduar. Ne vecanti duhet verifikuar qe siperfaqet e brendshme dhe te jashtme te tubacioneve dhe/ose rakorderite prane ekstremiteteve per tu salduar jane te lira nga gdhendjet dhe gervishjet perkatese dhe se ato respektojne tolerancat ne trashesi, te gjithe diametrave te jashtem, dhe ovalitetin maksimal te lejuar nga standartet e aplikuara te prodhimit.

Sa here qe ovaliteti eshte i tepruar, mund te shfrytezohen mjete qe rrumbullakosin materialin: nuk

---

lejohet nxehtesia ne skaje.

Siguroni qe fund ii tubit te kundert te siperfaqes saldimit eshte i mbyllur me tape mbrojtese.

## 7.3.2 KONTROLI I PAISJEVE TE SALDIMIT

### 7.3.2.1 KONTROLI PARAPRAK I PAISJEVE TE SALDIMIT

Para fillimit te operacioneve te saldimit, duhet te vleresohet efikasiteti i paisjeve qe do perdoren.

Ne vecanti, duhet te behen kontrollet qe vijojne:

- Kontrolli i efikasitetit te instrumentave te matjes qe saldatori eshte i paisur (matesi presionit, termometer, matesa kohe);
- Kontrolli i temperatures se elementit termik: ne cdo pike te te dyja siperfaqet, temperatura e matur me nje termometer digital te kalibruar duhet te jete brenda nje tolerance  $\pm 10$  °C, ne lidhje me vleren e vendosur ne termostat;
- Kontrolli i efikasitetit te mbeshteteseve shtrenguese nga saldatori mund te verifikohet nese jane ne shtrirje te sakte pjeset per tu salduar dhe ne paralelizem siperfaqet ne kontakt;
- Kontrolli i efikasitetit te frezes.

### 7.3.2.2 KONTROLI PERIODIK I PASIJEVE TE SALDIMIT NE KUSHTET E OPERIMIT

Ne fillim te cdo dite pune, eshte e nevojshme per te kontrollua kushtet e operimit te paisjeve ne dispozicion (elementin termik, saldatricen dhe frezen).

Ne vecanti duhet verifikuar, permes nje termometri dixhital te kalibruar, qe temperatura e te dyja siperfaqeve te elementit termik ne zonen e afektuar nga saldimi eshte brenda nje tolerance  $\pm 10$  °C ne lidhje me vleren e vendosur ne termostat (shih 11.1).

Gjithashtu, menjehere para fillimit te operimit te saldimit, eshte e rekomanduar te bejme nje test bashkim saldimi per te verifikuar eficiencen e sistemit te paisjeve te perdorura.

### 7.3.2.3 KONTROLI I SIPERFAQEVE TE ELEMENTIT TERMIK

Para cdo pune saldimi duhet verifikuar qe siperfaqet e elementit termik jane te lira nga gjurmet e yndyrave, pluhuri, dhe mbetjeve te polietilenit: kur jane prezent, ato duhen hequr.

### 7.3.2.4 KONTROLI I SALDATOREVE

Saldatoret e punesuar per ekzekutimin e bashkimit me saldim duhet te jene te trainuar si duhet dhe certifikuar sipas Standartit UNI 9737.

---

### 7.3.3 PERGATITJA PER SALDIM

#### 7.3.3.1 PASTRIMI I SIPERFAQEVE

Para pozicionimit te elementit per tu salduar, siperfaqet e tyre te brendshme dhe te jashtme duhen pastruar dhe te hiqen gjurmet e pluhurit, yndyrnave dhe cdo pisllek. Kjo duhet te kryhet me nje leckë pastrami qe eshte e lire nga fibrat, e lyer me nje detergjent te pershtatshem te lengshem (per shembull, klorid metileni, alkol isopropyl, ose chlorothene trichloroethane).

### 7.3.4 MBYLLJA E SKAJEVE

#### 7.3.4.1 MBYLLJA

Tubacionet dhe/ose rakorderite duhet te jene te mbyllura ne mbeshtetset e saldatorit keshtu qe siperfaqet e saldimit jane paralele me njeri tjetrin dhe mundesia e levizjes pa ferkime te konsiderueshme eshte e garantuar, duke perdorur kambaleca ose mjete jo lekundese ne te cilen tubat mund te rreshqasin.

#### 7.3.4.2 POZICIONIMI

Tubat dhe/ose rakorderite duhet te pozicionohen ne menyre qe te mos permbajne mosshtrirje me tolerancen; kur eshte e mundur, rrotullohen dy elementet deri sa gjendja me e favorshme e bashkimit eshte prezente dhe/ose veprojne ne nollat e sistemit te fiksimit pa ushtruar nje force te tepruar mbyllje qe mund te demtojë siperfaqet e produktit te prodhuar.

### 7.3.5 BERJA E SKAJEVE PER TU SALDUAR

Fundet e dy elementeve per tu salduar duhet te bluhën per te siguruar nje paralelizem te duhur dhe per te eliminuar gjurmet e ndryshkut. Operimi i bluarjes duhet te kryhet nga avancimi i pjeseve vetem pasi bluarja eshte aktivizuar dhe nga ushtrimi i presionit gradual qe nuk con ne ndalimin e aparatures dhe duke shmangur mbinxehjen e tepert te siperfaqeve ne kontakt.

Ne nje menyre te vazhduar duhet te krijohen ashkela te makinerise se bluarjes ne te dy skajet per tu salduar: perndryshe duhet te kontrollohen tolerancat e bashkimit ose duhet investiguar materiali qe perbejne tubat dhe/ose rakorderite.

Freza duhet te fiket vetem pas heqjes se ekstremiteteve te salduara.

Ne fund te frezimit, duhen hequr ashkelat nga siperfaqet e brendshme te elementeve te salduar, duke perdorur nje furce ose nje leckë te paster. Siperfaqet e bluara nuk duhet te preken me duar ose te ndoten ne nje menyre tjeter.

---

### 7.3.6 KONTROLLI I PERGATITJES SE SKAJEVE PER TUSALDUAR

Pas perfundimit te operimit te bluarjes, ajo duhet verifikuar, duke sjelle siperfaqet per tu salduar ne kontakt me njera tjetren nese ndodh mos shtrirja dhe drita ndermejt skajeve brenda tolerancave te kerkuara me poshte.

Mosshtrirja maksimale, e matur ne cdo pike te perimetrit nuk duhet te jete me e madhe se 10% e trashesise se elementeve per tu salduar, me nje maksimum 2 mm. Perndryshe, operimi i mbylljes dhe bluarjes/frezimit duhet te perseritet.

Drita ndermjet skajeve ne kontaktin me njera tjetren duhet te jete me pak se vlerat e treguara me poshte. Perndryshe operimi i frezimit duhet te perseritet.

|                         |             |         |             |         |
|-------------------------|-------------|---------|-------------|---------|
| Diameter i jashtem (mm) | deri ne 200 | mbi 200 | deri ne 400 | mbi 400 |
| Drita maksimale (mm)    | 0.3         | 0.5     | 0.7         | 1       |

Duke perdorur matesin e presionit qe saldatricja eshte paisur, gjurma e presionit Pt e nevojshme per te lejuar levizjen e mbeshteteses levizese te saldatrices: gjurma e presionit Pt nuk duhet te jete me e madhe se vlera e presioneve P (faza 1) dhe P (faza 5) e perdorur gjate ekzekutimit te bashkimit dhe treguar ne te dhenat teknike te saldatrices te dhena nga prodhuesi.

Punimet e saldimit menjehere duhet te ndjekin fazen pergatitore te skajeve. Ne kushtet e kantierit te ndertimit, gjenden kurdohere per tu depozituar gjurmet e pluhurit, yndyrave, ose pislleqeve te tjera ne skajet per tu salduar ne nje periudhe te shkurter te kohes ndermjet operimit te frezimit dhe fillimit te saldimit, menjehere duhet kryer pastrami pershkruar ne 7.3.3.1.

### 7.3.7 CIKLI I SALDIMIT

Saldimi i bashkimeve koke me koke te tubave prej polietileni dhe/ose rakorderive me paisje saldimi me goditje te nxehte duhet te kryhet duke realizuar fazat e ndryshme te ciklit te saldimit raportuar ne katalogun teknik te prodhuesit per tubat e trashesive te ndryshme. Ne vecanti:

Faza 1: Bashkimi dhe Para-nxehja.

Faza 2: Nxehja.

Faza 3: Largimi i termo-elementit.

Faza 4: Arritja e presionit te saldimit

Fazat 5-6: Saldimi.

Faza 7: Ftohja.

Parametrat e saldimit (temperature e termo-elementit, presionet, kohet), vlerat relative, dhe metoda ekzekutive duhet te leshohet nga prodhuesi i tubacioneve: ne vecanti, gjatesia e fazave te

ciklit te saldimit eshte e lidhur me kushtet e mjedisit te vendosura ne Nen-Artikullin 7.2.12.

Parametrat e saldimit te adoptuara per ekzekutimin e cdo bashkimi individual duhet te regjistrohen ne sistemin e regjistrimit te makinerise se saldimit, ose ne perputhje me Supervizorin, ne nje forme te pershtatshme.

### 7.3.8 ZGJEDHJA E PARAMETRAVE TE SALDIMIT

Parametrat e saldimit duhen perzgjedhur duke ndjekur ciklet e saldimit 1 ose 2 sipas trashesise se tubacioneve dhe rakorderive qe do perdoren, dhe ne vecanti:

Temperatura e termo-elementit duhet te jete

$T = 210 \pm 10 \text{ }^{\circ}\text{C}$  per  $s < 20 \text{ mm}$

$T = 230 \pm 10 \text{ }^{\circ}\text{C}$  per  $s \geq 20 \text{ mm}$

Per te garantuar ekuilibrin e nevojshem termik, duhet pritur per te pakten pese nderhyrje nga termostati, per arritjen e temperatures se vendosur para fillimit te punimeve te saldimit.

Vlerat e presionit, te cilat varen nga tipi i saldatrices se perdorur, jane nxjerre nga tabelat e dhena nga prodhuesi i saldatrices dhe mund te llogaritet duke ditur seksionin e cilindrit shtytes te qarkut komandues.

Presioni gjurmues  $P_t$  matur ne menyre eksperimentale dhe e ndryshueshme mbi bazat e rast pas rasti duhet ti shtohet ketyre vlerave.

Para fillimit te punimeve te saldimit, per cdo diameter dhe PN, presionet e punes ne lidhje me makinerine duhen percaktuar dhe regjistruar.

Vlera e presionit  $P_2$  (faza 2), e njejte per te dy ciklet, duhet garantoje kontaktin ndermjet skajeve dhe termo-elementit gjate te gjitha fazave. Vlera e presionit  $P_2$  nxirret direkt nga tabelat e dhena nga prodhuesi i saldatrices dhe mund te llogaritet duke njohur seksionin shtytes te qarkut komandues.

## 7.4 FAZAT E SALDIMIT

### 7.4.1 FAZA 1: BASHKIMI DHE PARA-NXEHJA

Kjo eshte e njejte per te dy ciklet.

Pozicioni i termo-elementit ne saldatrice, duke pasur kujdes per te vendosur ate ne menyre korrekte per garantimin e stabilitetit te tij ne mbeshtetset ne bazen e makinerise.

Bashkimi i termo-elementit me skajet dhe aplikimi presionit ( $P_1 + P_t$ ) per nje kohe  $t_1$  te mjaftueshme per te lejuar, ne te dyja skajet e saldimit, formimin e nje tegeli me gjeresi  $A$ , shprehur

---

ne milimetra, i cili mund te percaktohet nga parametrat e saldimit leshuar nga prodhuesi ne kolonen "Initial beat-up-tundja fillestare".

#### 7.4.2 FAZA 2: NXEHJA

Kjo eshte e njejte per te dy ciklet.

Per formimi i shiritit me gjeresi A, presioni i kontaktit te skajeve me termo- elementin bie ne vleren P2.

Mbajtja e skajeve ne kontakt me termo-elementin per kohen t2, shprehet ne sekonda.

#### 7.4.3 FAZA 3: HEQJA E TERMO-ELEMENTIT

Kjo eshte e njejte per te dy ciklet. Per heqjen e termo-elementit, duhet kujdes per mos demtimin e skajeve te dy elementeve per tu salduar.

Heqja e termo-elementit duhet te jete e shpejte, per te shmangur ftohjen e tepert te skajeve te nxehta. Periudha e kohes, e shprehur ne sekonda, ndermjet heqjes se termo-elementit dhe kontaktit te tij me skajet (Faza 4) duhet, megjithate, te jete me pak se t3.

#### 7.4.4 FAZA 4: ARRITJA E PRESIONIT TE SALDIMIT

Me termo-elementin e hequr, vendosja e skajeve ne kontakt nga rritja e presionit ne vleren (P5 + Pt) (Faza 5) ne nje menyre progressive dhe ne nje menyre te tille per te shmangur heqjen e papritur dhe te tepruar te materialit te bute nga siperfaqet e bashkuara. Arritja e presionit te saldimit (P5 + Pt) duhet te ndodhe ne kohen t4, e shprehur ne sekonda.

#### 7.4.5 FAZA 5 – 6 SALDIMI PER TUBACIONET ME TRASHESI <20 MM

Mbajtja e skajeve ne kontakt ne presionin (P6 + Pt) per kohen t6, e shprehur ne sekonda

#### 7.4.6 SALDIMI PER TUBACIONET ME TRASHESI 20 MM

Mbajtja e skajeve ne kontakt ne presionin (P5 + Pt) per kohen t5, e shprehur ne sekonda, dhe pastaj presioni me i ulet se vlere (P6) + Pt per kohen t6, e shprehur ne sekonda.

#### 7.4.7 FAZA 7: FTOHJA

Pas periudhes se saldimit (Faza 5 ose 6 sipas ciklit), bashkimi i salduar mund te hiqet nga saldimi, pa iu nenshtuar forcave te dukshme, dhe nuk duhet tensionuar deri ne fund te kohes se ftohjes t7: me tej, duhet siguruar nje zone per mbrojtjen e saldimit nga agjentet atmosferike (shiu, era, rrezet e teperta te diellit).

---



Ftohja e bashkimit te salduardhet te ndodhe ne nje menyre natyrale: ftohja e pershpjtuar me uje, ajer te kompresuar, ose metoda te tjera nuk eshte elejuar.

## 7.5 KONTROLI I LIDHJEVE ME SALDIM

### 7.5.1 KONTROLLET JO-DESTRUKTIVE

#### 7.5.1.1 EKZAMINIMI VIZUAL

Ekzaminimi vizual i perket kontrolleve te meposhtme:

- Tegeli i saldimit duhet te jete uniform permes perimetrit te bashkimit/lidhjes;
- Gdhemdja ne qender te tegelit duhet te mbetet mbi diametrin e jashtem te elementeve te salduar;
- Nuk duhet te kete evidence te porozitetit, shtim te pluhurit, dhe te kontaminimeve te tjera mbi siperfaqen e jashtme te tegelit;
- Nuk duhet te kete deshmi per thyerje siperfaqesore;
- Siperfaqja e jashtme e tegelit nuk duhet te shprehe nje shkelqim te tepert, nje tregues te mbinxehjes se materialit te salduar.

#### 7.5.1.2 EKZAMINIMI DIMENSIONAL

Ekzaminimi dimensional i perket kontrolleve te meposhtme:

- Ne cdo pike te saldimit, gjeresia B e tegelit duhet te jete brenda vlerave te treguara ne Tabelen qe vijon.

| Trashesia e elementeve te salduar (mm) | Gjeresia e tegelit B (mm) | Gjeresia e elementeve te tegelit (mm) | Gjeresia e tegelit B (mm) |
|----------------------------------------|---------------------------|---------------------------------------|---------------------------|
| 3                                      | 4 - 6                     | 22                                    | 13 - 18                   |
| 4                                      | 4 - 7                     | 24                                    | 14 - 19                   |
| 5                                      | 5 - 8                     | 27                                    | 15 - 20                   |
| 6                                      | 6 - 9                     | 30                                    | 16 - 21                   |
| 8                                      | 7 - 10                    | 34                                    | 17 - 22                   |
| 9                                      | 8 - 11                    | 40                                    | 18 - 23                   |
| 11                                     | 9 - 12                    | 45                                    | 20 - 25                   |
| 13                                     | 10 - 14                   | 50                                    | 22 - 27                   |
| 16                                     | 11 - 15                   | 55                                    | 24 - 30                   |
| 18                                     | 12 - 16                   | 60                                    | 26 - 32                   |
| 19                                     | 12 - 18                   | 65                                    | 28 - 36                   |

Gjeresia B e tegelit duhet te jete uniform ne te gjithë zhvillimin e saldimit: ne cdo pike te saldimit, gjeresia B e saldimit duhet te varioje nga  $\pm 10\%$  ne lidhje me vleren mesatare

$$B_m = (B_{\min} + B_{\max})/2$$

ku  $B_{\min}$  dhe  $B_{\max}$  jane respektivisht minimum dhe maksimumi i vlerave te matura te gjeresise B te tegelit te saldimit te ekzaminuar.

Ne cdo pike te saldimit, diferenca maksimale ndermjet dy kordoneve  $b_1$  dhe  $b_2$  qe perbejne shtesen e tegelit duhet te jete me pak se 10% e gjeresise B te tegelit ne rastin e nje bashkimi tube-tube dhe 20% ne rastin e nje bashkimi/lidhje tube-rakorderi iserakorderi-rakorderi.

Mungesa e shtrirjes maksimale e dy elementeve te salduara duhet te jete me pak se 10% e trashesise se tyre s.

#### 7.5.1.3 EKZAMINIMI PERMES HEQJES SE TEGELIT

Tegeli i jashtem i saldimit mund te hiqet me paisje prerje-tegeli te pershtshme.

Tegeli duhet te ekzaminohet ne brendesi te siperfaqes per te zbuluar ndonje perfshirje te pluhurit apo kontaminimeve te tjera dhe vertetuar rregullsine e tij ne perimenter, dhe duhet vendosur ne disa pika per te treguar siperfaqet me bashkimet.

## 7.6 KERKESAT PER IMPLEMENTIMIN E TUBACIONEVE PE100 DHE RAKORDERIVE

### 7.6.1 TRANSPORTI DHE GRUMBULLIMI I TUBACIONEVE PE100

Transporti i tubacioneve duhet te kryhet me mjetet dhe metodat e treguara nga Kompania Furnizuese. Ne cdo rast rregullat ne kufizimin e ngarkeses jane te percaktuara te detyrueshme ne Kodin Rrugor.

Ne cdo rast ngarkimit dhe shkarkimi nga mjetet e transportit duhet kryer me nje vinc ose krah eskavatori. Tubacionet duhet te ngrihen ne zonen qendrore me nje kunderpeshe te nje amplitude te barabarte te pakten 3 meter, paisur me litaret ose rripat prej najloni ose celiku te veshur.

Platform mbeshtetese duhet te nivelohet dhe te jete e lire prej ashpersise dhe gureve te mprehte. Shkarkimi dhe grumbullimi mbi zhavorr, rere, asphalt dhe cemento lejohet duke shmangur zvarritjen e tubit.

Shkarkimi duke u rrotulluara nga mjetet e transportit me ane te nje plani te pjerrtet eshte i lejuar, me kusht qe platform mberritese eshte e perbere nga toke e mbjelle ose tubi mbeshtetet mbi lidhjet kryqe.

Lartesia e grumbullit nuk duhet te kaloje 2.00 meter, pavaresisht nga diametri i tubave.

### 7.6.2 GERMIMI DHE KERKESAT E TIJ

Kontraktori do te kryehe germimet me mjete te pershtatshme, me kujdesin me te madh ne:

- Respektimin me perpikmeri te kerkeses per krijimin e nje ambient pune te sigurte;
- Parandalimin e shembjeve te mureve nga mjetet, te dyja per te shmangur aksidentet e stafit, dhe per te mos modifikuar seksionin e germimit;
- Eleminimin menjehere si brenda germimit dhe ne zonen perreth te ndonje rrenje me zhvillim pauses qe mund te demtoje tubacionin;
- Te shohe me cdo kusht ne menyren me te mire, per mbledhjen dhe largimin e ujrave te shiut, si dhe ato te cdo uji nentokesore apo burimesh te hasura;
- Grumbullimin e materialit te germuar ne nje distance qe lejon levizjen e lire te personelit dhe tubit per te shmangur rrezikun nga renia e ketij materiali dhe ne vecanti te gureve mbi produktin gati te shtrire, gjithashtu duke u kujdesur per te mos penguar ndonje trafik siperfaqesor.
- Gjate hapjes se kanaleve ne terrene heterogjene, kodrinore dhe malore, eshte e nevojshme te mbrohet kanali ndaj rreshqitjeve te mundshme ose shkarjeve permes mbeshteteseve te duhura dhe punimeve te ankorimit.
- Nese ka arsye per te besuar se ndonje uje nentokesor present ne germim mund te coje ne paqendrueshmerine e tokes se percaktuar dhe te muratures se prodhuar, keshtu eshte e nevojshme per te konsoliduar/forcuar terrenin perrreth me punime drenazhi qe veprojne deri ne nivelin e germimit, dhe per te shmangur menjehere ne menyre qe ujerat nentokesore te mos provokojne levizjet e materialit shtrires qe rrethon tubin.

Gjeresia e germimit duhet te jete e mjaftueshme per te lejuar nje rregullim te fundit dhe nje lidhje te thjeshte te elementeve te ndryshem te tubacionit. Per me teper, kur nuk ka ndikime precise te dizajnit, gjeresia ne fundin e germimit duhet te jete e barabarte me diametrin e tubit te rritur nga 20 centimetra ne ted y anet, pervec nese ka kerkesa te ndryshme nga Supervizori.

### 7.6.3 SHTRATI-SHTRIRJES

Nese nuk shprehet ndryshe, shtrirja e tubacioneve duhet bere ne lidhje me rregullat qe vijojne.

- EN 1295: Dizajni strukturor i tubacioneve te groposur nen kushte te ndryshme te ngarkeses  
Pjesa 3: Metoda e perbashket
  - ENV1046:2003: Tubacionet plastike dhe sistemet e kanaleve – Sistemet jashte strukturave ndertimore per transmetimin e ujit ose ujrave te zeza – Praktikant per instalimin mbi dhe nen toke
-

- EN1610:1999: Ndertimi dhe testimi i lidhjes se kanalizimeve dhe kolektorit te kanalizimeve
- pN E13089730: Puna e shtrirjes dhe testimi i sistemeve te tubave prej polietileni per te transportuar ujerat e zeza nen presion.

Natyra e fundit te kanalit ose me ne pergjithesi, e terrenit ne te cilen tubacionet do te mbeshteten, duhet te jete uniforme rezistente dhe duhet te perjashtoje cdo mundesi te demtimit duke u perhapur nga nje pike e tubit ne tjetren. Ne fundin e kanalit, guralecet e niveluar dhe te lire, shkembijnje apo materialet e tjera qe pengojne nivelimin e persosur, duhet mbivendosur nje shtrese e reres per te krijuar nje siperfaqe te sheshte qe siguron shperndarjen uniforme te ngarkeses pergjate tere tubacionit.

Trashesia e shtratit mbeshtetes duhet te pakten te jete 15 centimetra. Materiali duhet te perbehet kryesisht nga granula me nje diameter 5 milimeter dhe duhet te permbaje me pak se 12% grimca te imta (percaktuar si grimca me pak se 0.08 milimeter) dhe, per kete arsye plotesojne kerkesat e raportuara ne specifikimet prezente.

Per te permiresuar cilesine e shtratit shtrires te kolektoreve kryesore, duhen perdorur thase rere te vendosura sipas propozimit te Supervizorit. Karakteristikat kryesore te thaseve jane treguar si vijon.

#### 7.6.4 THASET E RERES

Thaset e reres ne pergjithesi do te kene dimensione maksimale perafersisht 50 x 70 cm. Dimensionet e tjera duhet te kerkohen ne kete projekt. Thaset duhet te perbehen prej gjeotekstili rezistent i larte me karakteristikat qe vijojne (vetem nese eshte e kerkuar ndryshe nga Supervizori):

- pesha 200-300 g/m<sup>2</sup>
- forca elastike 30-40 kN/m

Poroziteti i gjeotekstilit duhet lidhur me granulometrine e materialit mbushes per te shmangur humbjen e saj.

Tekstili do te jete rezistent ndaj agjenteve kimik dhe fizik te ujrave te detit, i zi dhe i stabilizuar ndaj U.V.

Qeset/thaset duhet te paketohen pershtatshem ne menyre qe te marrin persiper formen e nje ene te rregullt, heqjen e ajrit qe ndodh gjate fazes lancimit, keshtu qe do te kontrollohen me saktesi mbi sasine e rregullt te mbushjes se ndodhur. Mbyllja e qeses/thesit do sigurohet permes qepjes duke perdorur nje fije te stabilizuar U.V., karakterizuar nga nje rezistence e krahasueshme me ate te tekstilit.

---

#### 7.6.5 SHTRIRJA E TUBACIONIT PERGJATE KURSIT

Tubacioni dhe pjeset special do transportohen pergjate rrjedhes pa i terhequr ato dhe duke u kujdesur per te shmangur gervishjet, prerjet ose demtime te tjera.

Kursi do piketohet dhe pozicionet e pjeseve special do shenohen, sipas metodës te vendosur nga Supervizori.

Tubat dhe pjeset speciale duhet te shtrihen prane germimit, duke u kujdesur qe gjatesia e tubit te jete e barabarte me ate te kursit rrjedhes, dhe qe numri dhe tipi i pjeseve speciale te korrespondoje me te dhenat e dizajnit. Nese tubacioni eshte i vendosur ne nje zone trafiku, tubat duhen grumbulluar ne grupe prej 10-15 bare (120-180 meter) ne menyre qe te pozicionohen lehte ne momentin e vendosjes pergjate germimit.

Kerkesat e shkaktuara per kalimin e eskavatoreve dhe te akumulimit te materialit te germuar duhet mbajtur mend ne sistemimin e tubacioneve.

#### 7.6.6 LAKIMI NGA KTHESA NATYRORE

Tubacionet PE100 mund te vendosen te ftohta, pa tendosje te tepert te materialit, me nje rreze minimale te ktheses te barabarte me 40 here te diametrit ( $R = 40 D$ ).

Kthesat horizontale duhet te bllokohen ne germim me thaset e reres para mbushjes ne menyre qe te shmangin nje situatë ku tubi shtyhet ne muret e vete germimit.

Perpunimi ne te nxehte i tubave dhe/ose pjeseve special ne fushe absolutisht eshte i ndaluar.

#### 7.6.7 KRYQEZIMET

Kryqezimet midis tubit me tub ose ndermjet tubit dhe rakorderive ose paisjeve, etj. duhet te jete ne perputhje me tippet e raportuara me poshte. Kerkesat e raportuara per cdo tip te kryqezimit kane nje karakter tregues; megjithate, duhet ndjekur cdo kerkese nga furnizuesit.

#### 7.6.8 KRYQEZIMET PER SALDIM

Keto gjithmone duhet te kryhen nga personel i kualifikuar dhe certifikuar sipas standartit UNI9737 klasa P2 me zgjatje S ose P3 me zgjatje S, ne varesi me saldimin qe do krijohet (koke me koke ose me kemishe/mbeshtjellje termike), me paisje te duhura, per te garantuar te mos ndodhe mundesia me e vogel e gabimit ne temperatura, presione, dhe kohe, duke miratuar mbrojtjet e duhura ne rastin e shiut, eres ose pluhurit te tepert.

#### 7.6.9 SALDIMI KOKE ME KOKE

Saldimi koke me koke do kryhet sipas kerkesave te "Procedures per montimin dhe saldimin e

---

tubacioneve PEAD "PE100" me metoden me paisje saldimi te nxehte per bashkimet koke me koke".

#### 7.6.10 SALDIMI ME KEMISHIM TERMIK

Saldimi koke me koke do te kryhet sipas kerkesave te "Procedures per montimin dhe saldimin e tubacioneve PEAD "PE100" me metoden me paisje saldimi te nxehte per bashkimet koke me koke".

#### 7.6.11 TIPI I BASHKIKMIT MEKANIK GILBAUT, ME MBYLLJE/PLUMBIM PERMES RONDELES ELASTOMERIC

Ky tip bashkimi/kryqezimi mund te kryhet ne cdo tip tubacioni, edhe ndermjet tipeve te tubacioneve me material te ndryshem, me kusht qe ato te kene te njejtin diameter te jashtem.

Cfaredo forme te jashtme dhe tipi te shtrengimit me te cilin ky bashkim realizohet, gjatesia e tij e pergjithshme, dmth. distanca aksiale ndermjet dy rondeleve, nuk duhet te jete me pak se shuma e variacioneve maksimale lineare qe mund te ndodhe nga efekti termik ne dy tubat per tu bashkuar, plus nje sasi e ndryshueshme nga 30 deri 100 milimetra ne lidhje me diametrin e vete tubacioneve.

Lidhja/kryqezimi do kryhet sipas ketij rendi punimesh:

1. Pastrimi teresisht i pjeseve qe do bashkohen dhe sigurimi qe ato sjane prekur;
2. Shtesa ne dy ekstremet e dy tubacioneve ne bashkimin mekanik dhe sigurimi qe sejcili prej tyre eshte future per nje gjatesi qe i korrespondon sepaku 1/3 se gjatesise se kemishimit, duke pasur kujdes, megjithate, qe ato te mos vijne ne kontakt me njera tjetren;
3. Pjeset e bulonave, rondeleve, dhe kundravidave, duke i shtrenguar ato terthorazi.

#### 7.6.12 BASHKIMI ME ANKORIM PERMES NJE UNAZE OSE DADO RRETHORE TE NDARE

Ky tip bashkimi do realizohet sipas rendit te operacioneve qe vijojne:

1. Prerja e tubit ne gjatesine ekerkuar;
  2. Ndarja e pjeseve nga rakorderite dhe montimi tyre ne tub, duke filluar me dadon unaze, ndjekur nga unaza shtrenguese konike, duke treguar kujdes qe eshte vene ne drejtimin e duhur, i.e. me pjesen me te madhe te terminalit drejtmontimit;
  3. Shtese tubi ne trupin emontimit derisa ajo shtrihet pertej rondeles elastomerike dhe prek koken e bashkimit te brendshem te trupit te montuar;
  4. Ciftimi i unazes konike shtenguese me trupin e montimit dhe shtrengimi me vide te vete montimi.
-

#### 7.6.13 BASHKIM I FLLAXHES SE LIRE ME KOLLAREMEBSHTETESE

Ky tip bashkimi mund te behet gjithashtu ndermjet tubave te materialeve te ndryshme ose per me pjeset speciale. Ajo realizohet me svendosjen e flanaxhave me rreshqitje ne kollaret salduese

Fllaxhat mund te jene prej celiku karboni normal, celiku te plastifikuar, ose materiali tjetër te pershtshem per kete qellim.

Bashkimi do kryhet sipas rendit te punimeve qe vijojne:

1. Vendosja e flanaxhes se lire ne ekstremitetin e tubit;
2. Bashkimi i kollares mbeshtetese me tubin;
3. Rregullimi i rondeles elastomerike ne vendin e duhur te kollares;
4. Mbyllja e saj nga shtrengimi terthorazi.

#### 7.6.14 BASHKIMI ZGJERUAR

Kur eshte kusht tipi i bashkimeve te zgjeruara me “paisje me qese ajri” or “teleskope”, ajo duhet miratuar sipas treguesve te S.M. e cila perndryshe, nese perdorimi i ketyre lidhjeve nuk konsiderohet i pershtatshem, organizohet bllokimi i levizjeve gjatesore te tubacionit permes ankorave te vendosura dhe te permasuara ne menyre te pershtshme.

#### 7.6.15 LIDHJET ME MATERIALET E TJERA

Perdorimi i ngjiteseve ose llacit te cimentos eshte i ndaluar sa here qe bashkimi i tubacionit PE me tipet e tjera te tubave (metalike ose nje tipi te ndryshem plastik) eshte i nevojshem. Supervizori do jape mendimin e tij rreth sistemit te zgjedhur.

Lidhja midis tubave PE100 me paisje metalike, zakonisht e paisur me mbyllje me flanaxha duhet te kryhet permes bashkimit me flanaxhe normale.

Paisja e lidhur ne kete menyre mund te ankorohet ne blloqe betoni, ne menyre qe te mos shkaktoje perkulje dhe/ose force rrotulluese ne produktet fqinje.

Saldimi ndermje tubacionit PEAD qe ka vlere te ndryshme MRS eshte i mundshem. Vlefshmeria e lidhjes do verifikohet nga testi/prova e kryer ne nje presion te brendshem ne 80 °C ne perputhje me kushtet e draftin te Standartit pr EN 12201.

#### 7.6.16 INSTALIMI I TUBACIONIT

Me perfundimin e shtratit shtrires, tubacionet, rakorderite, pjeset speciale, etj. Do shtrihen pergjate germimit, me kujdes duke kontrolluar perputhjen dimensionale me te dhenat e projektit. Para hedhjes ne germim, duhet te ekzaminohen te gjitha elementet e tubave me kujdes me theksim te

---

vecante ne kokat e tyre, per tu siguruar qe ato nuk jane perkeqesuar/demtuar gjate transportit dhe punimeve te ngarkim shkarkimit. Per kete qellim, eshte e domosdoshme qe ato te pastrohen nga pluhuri, balta, etj. qe mbulojne tubat dhe mund te fshehin ndonje demtim.

Duhet verifikuar qe nuk ka hyre brenda tubacioneve dhe rakorderive ndonje kafshe apo material i huaj; per te korrigjuar kete problem, rekomandohet kapak fundore i duhur i linjave qe tashme jane vendosur.

Kur sistemi eshte i fiksuar i teri dhe tubacioni e pjeset special jane lidhur plotesisht sipas metodave te pershkruara ne Kapitullin present; ajo duhet te kryhet ne pergjithesi nga eskavatoret ose vincat e vendosura pergjate traktit, ne menyre qe te lejojne uljen graduale te tubacionit, dhe nuk duhet te pesojne ndikime kundrejt trupave te forte ose deformime te teperta gjate kurseve te operimeve.

Tubacionet PE100, saldimi i te cilave te kryhet ne anet e germimit, do vihen ne vend duke i ngritur nga toka te pakten ne dy pika cdo te pakten 15-20 meter nga njera tjetra, per jo me shume se 1.20-1.30 meter. Per tubacione me diameter me te vogel dhe germime qe nuk jane shume te thella, gjithashtu eshte e mundur te kryhet shtrirja me dore.

Paisjet qe potencialisht mund te vendosen ne tubacione duhet te mbeshteten qe te mos ushtrojne presion mbi tubacione.

#### 7.6.17 ANKORIMET

Ne traktin e tubacionit, ku perdorimi i bashkimeve rreshqitese me rondele elestomerike eshte i parashikuar ne korrespondence me kurben ose ndonje lartesi, masat e betonit duhet te pergatiten me qellim te shperndarjes se goditjes per shkak te presionit te brendshem ne muret e germimit.

Keto blloqe ankorimi duhet te llogariten nga Supervizori me formulat qe vijojne:

$$F = K p S$$

ku:

- $K = 1.00$  per ekstremitetet dhe  $T$  e  $90^\circ$ ;
- $1.14$  per kurbat  $90^\circ$ ;
- $0.766$  per kurbat  $45^\circ$ ;
- $p$  = test ii presionit maksimal te brendshem;
- $S$  = seksioni i brendshem i tubit ne  $\text{cm}^2$ ; seksioni derivues per reduktim  $T$  ne  $\text{cm}^2$ .

Reagimi godites i tokes jepet nga:  $B = K_1 H S_1$

Koeficienti  $K_1$  varet nga natyra e tokes dhe eshte:

- $3.000 \text{ Kg/m}^3$  per argjilen ranore
- $5.000 \text{ Kg/m}^3$  per dheun me ngjeshje te mesme
- $6.000 \text{ Kg/m}^3$  per reren dhe zhavorrin



H = thellesia e groposjes matur ne meter, ne lidhje me aksin e tubit;

$S_1$  = seksioni mbeshtetes ( $L \times h$ ) shprehur ne  $m^3$ ; L = gjeresia e mases se ankorimit dhe h = lartesia e tij.

Eshte e nevojshme te permasojne  $S_1$  keshtu qe  $B > 1.5 F$ . Kjo mase duhet te vendoset ne te gjithë paisjet ndihmese (valvolat, shkarkimet fundore, etj.) qe mund te ushtrojne shtypje ne tubacione.

#### 7.6.18 MBESHTETJA E TUBACIONEVE DHE MBULIMI I GERMIMIT

Mbeshtetja e tubacioneve dhe mbushja fillestare e germimit, dei ne 20 cm nga maja e ekstremit te siperm te tubit, duhet te kryhet me rere duke pasur nje volum te thate peshe prej 1.9 t/m<sup>3</sup>; permbajtja maksimale gelqerore e kufizuar ne 10%, dhe permbajtje maksimale argjile e kufizuar ne 5%.

Mbeshtetja duhet te kryhet nga materiali qe sillet i pari rrotull aneve te tubacionit deri ne nivelin diametrik te tij dhe pastaj, duke shtyre materialin nen tubacion me ndihmen e nje lopate dhe duke mbuluar ate me dore ose mjet ngjeshes mekanik me peshe te lehte te pershtatshem (duke e bere me kujdes pa demtuar tubin).

Pasi kjo ka mbaruar, duhet kryer groposja e germimit deri ne 30 cm mbi pjesen superiore te tubacionit duke kryer ngjeshjen ne 20-30 cm trashesi shtresash. Ngjeshja do te kryhet eskluzivisht ne faqet anesore, jashte siperfaqes se zene nga tubacioni per te siguruar qe densiteti relative i materialit te groposur arrin 90% te vleres optimal te percaktuar me Testin e modifikuar Proctor.

Ne kete faze te pare bashkimet, rakorderite, derivacionet dhe ne pergjithesi te gjitha elementet duhet te lihen pa mbuluar per tu monitoruar me kujdes gjate testit operacional te tubacioneve.

Mbushja e njepasnjeshme duhet te kryhet ne shtresa te nje trashesie maksimale 30 cm qe mund te ngjeshet (me duar, me pjate shtyqe, ose paisje ngjeshese mekanike me peshe te lehte) njera pas tjetres se paku deri ne nje meter te mbulimit te majes se tubacioneve ne zonat e nenshttruara nga trafiku i lehte, dhe te pakten deri 1.50 meter ne zonat me trafik te rende.

Per lartesite e mbulimit me pak se ato te vendosura me lart, mbushja duhet te behet me nderhyrjen e nje membrane te ngurte per mbrojtjen dhe shperndarjen e ngarkesave, vendosur ne siperfaqen e shtreses te materialit konsistent dhe llogaritur duke marre ne konsiderate karakteristikat e tokes se instalimit, germimit dhe rezistences mekanike te tubit te perdorur.

Rekomandohet qe mbushja, vecanerisht per tubat e polietilenit te kryhet gjate oreve te fresketa te dites. Ajo kryhet ne zona prej 20-30 cm, duke avancuar vetem ne nje drejtim dhe ndoshta perpjete. Tre seksionet e njepasnjeshme do punohen dhe do pasohen ne te njejten kohe nga mbulimi (deri ne nje lartesi 50 cm nga tubi) ne nje zone, duke mbuluar (deri ne 15-20 cm nga tubi) ne zonen ngjitur dhe duke shtruar reren rrotull tubit ne trasene duke perparuar. Nje prej ekstremiteteve te

---

trasese se tubacionit do te mbahet gjithnje e lire per te levizur dhe do te kryhet bashkimi apo lidhja e pjeseve speciale pas rimbulimit te kryer prej 5-6 meters nga vete pusi.

Gjate groposjes dhe punimeve te ngjeshjes, duhet shmangur qe te kalojne ngarkesa te renda ne kanal.

Pas nje periudhe te pershtshme rregullimi, kompania do te shohe per sistemimin dhe restaurimin e shtrimit me cakell dhe shtrimit para ekzistuese.

Groposjet dhe shtrimi me cakell i restauruar duhet te kontrollohet vazhdimisht nga Kontraktori i cili, kur e gjen te nevojshme, derisa testimi te jete kryer do te vazhdoje me kujdes dhe me koston e tij te ripërterije ato me materialet e pershtatshme.

Nese germimet jane te vendosura ne toka te kultivuara, groposja duhet te kryhet duke perdorur mbetjet bujqesore per shtresen e sipërme dhe rimbushjet pasuese.

Kontraktori, edhe kur eshte e komplikuar me standartet e ketij paragrafi, do te kete pergjegjesi vete per cdo pasoje qendrueshmerie dhe sigurie.

Autoriteti kontraktues rezervon te drejten per te pare direct rimbushjen e mbushjes ne rastet e mospagimit nga Kontraktori per ndonje qellim sherbimi dhene nga Supervizori. Ne kete rast te gjitha shpenzimet do i ngarkohen Kontraktorit

## 7.7 TESTI I OPERIMIT HIDRAULIK

### 7.7.1 TE PERGJITHSHME

Tubacionet e realizuara duhet tu nenshtrohen nje testi hidraulik per te siguruar teresine e tubave, bashkimeve, rakorderive dhe komponenteve te tjere te linjes.

Paisjet e testimit duhet te kalibrohen periodikisht dhe personeli qe punon duhet te jete i pergatitut per kryerjen e testit, dhe i informuar rreth intensitetit te ngarkesave te aplikuara pasojat per shkak te ndonje thyerje.

### 7.7.2 METODOLOGJIA E TESTIMIT

Metodologjia e testimit ilustruar me poshte merr ne considerate sjelljet viskoelastike te polietilenit. Kerkesat jane:

- Gjatesia e cdo traseje te tubacionit te polietilenit, mund te testohet me diameter dhe tipe tubacionesh te ndryshem dhe numer te bashkimeve, paisjet e instaluara, kanalit dhe natyres se tokes se krosuar, por ne cdo rast nuk duhet te jete me e madhe se 800 metra.
- Tubacioni qe testohet duhet te mbyllet ne fundet/skajet permes filanxhave me bulona ose te kapakeve te salduar; perdorimi i valvolave te mbyllura ne ekstremitete eshte i kundërshtuar

sin je mjete i seksionimit gjate testimit.

- Mekanizmat ajer ventilues duhet te ofrohen ne pikat me te larta te tubacioneve. Prezenca e ajrit mbetes influencon negativisht ne rezultatin e testit.
- Pika e pompimit te presionit duhet te vendoset, kur eshte e mundur, ne piken me te ulet te tubacioneve per te favorizuar largimin e ajrit gjate mbushjes. Ky pozicion gjithashtu lejon leximin e ngarkeses maksimale hidrostatike dhe kontrollin me te larte gjate ekzekutimit te testit.
- Testimi duhet te kryhet pas mbulimit te tubacioneve, vetem duke lene bashkueset/lidhjet e pambuluara. Eshte e pershtatshme te arrihet nje nivel i mire i ngjeshjes se dheut ne mbulim per te parandaluar levizjet e teperta te tubacionit gjate presionit kalues.
- Gjate testit, temperature e trakut nuk duhet te varioje si pjese e vecorive viskoelastike te materialit qe mund te ndikojte negativisht ne efektin e rezultatit. Pas kryerjes se rimbulimit, eshte e nevojshme te pritet 24 ore para testimit keshtu qe temperature e tere trakut te jete stabilizuar. Pjeset e zbuluara te tubacionit duhet te mbrohen perkohesisht kundrejt ndryshimeve te temperatures qe shkaktojne rrezet e diellit.
- Sistemi me presion mund te jete mekanik ose manual dhe duhet te permasohet si duhet per te arritur presionin e testit te kerkuar.

Te gjitha valvolat me bullona e dado dhe ato jo kthyes duhet te permasohen si duhet per te arritur presionin e kerkuar te testit. Te gjitha valvolat me bullona e dado dhe ato jo kthyes duhet te kontrollohen para ekzekutimit te testit.

#### 7.7.2.1 PERGATITJA

- Para mbushjes se tubacionit, duhet te happen paisjet manual ventiluese te ajrit.
- Uji i perdorur per test duhet te jete i cilesise se mire qe te mos infektoj tubacionin dhe ujin qe percillet gjate operacionit vijues.
- Pastaj nje mbushje e ngadalte me uje me nje shpejtesi me pak se 1 m/s, duke shmangur gjenerimin e goditjeve te ujit dhe largimin e ajrit.
- Pas sigurimit qe tubacioni eshte mbushur plotesisht dhe ajri eshte nxjerre, mbyllen paisjet e ventilimit. Paisjet automatike duhet te jene te kontrolluara rregullisht gjate testit.
- Tubacioni plotesisht i mbushur duhet te lihet per tu stabilizuar per te pakten 3 ore por eshte e preferueshme te kryhet testi mbylles 24 ore pas mbushjes.

### 7.7.2.2 LLOGARITJA E PRESIONIT TE TESTIT

Presioni i testit (STP) llogaritet ne baze te presionit maksimal projektues (MDP) i cili eshte i njejte si presion maksimal operimi te sistemit te vendosur nga projektuesi. Ne kete llogaritje, nuk ka nevoje te merret ne considerate vlera e goditjes se rrjedhes.

Gjithashtu referuar DM LL PP 12 ne fuqi ne kohen e publikimit te standartit (12185 "Standarti Teknik perkates i tubacioneve. Subjekt i projektimit, zbatimit dhe testimit").

### 7.7.2.3 ZBATIMI I TESTIT

- Fillimi gradual nen presion i tubacionit derisa te arrihet vlera e presionit te testit STP. The STP vlera e presionit te testit nuk mund te jete me pak se 6 bar.
- Mbajtja e ketij presioni per 30 minuta, ri-stabilizimi i tij me pompim te nevojshem per te balancuar rritjen ne volumnet shkak te zgjerimit te tubacionit. Gjate kesaj faze duhet inspektuar sistemi per te identifikuar ndonje rrjedhje ne advance.
- Pastaj, presioni duhet te reduktohet shpejt, duke derdhur ujin nga sistemi derisa te arrije nje presion prej 300 kPa.
- Regjistrimi i vlerave te presionit interval kohe te rregullt si me poshte:
  - ndermjet 0 dhe 10 minuta: 1 lexuar cdo 2 minuta (5 lexime)
  - ndermjet 10 dhe 30 minuta: 1 lexuar cdo 5 minuta (4 lexime)
  - ndermjet 30 dhe 90 minuta: 1 lexuar cdo 10 minuta (6 lexime)
- Vlerat e mbushjes duhet te tregojne nje trend ne rritje te presionit ne pergjigje te sjelljes viskoelastike te polietilenit. Efekti viskoelastik i polietilenit ne kurben e kohes-presionit varet nga faktore qe perfshijne gjatesine e tubacionit te testuar, diametrin e tubit, si dhe eficencen e ngjeshjes se tokes. Prezenca e ajrit mbetes ne sistem dhe luhatjet e temperatures gjate testit influencojne negativisht ne rezultate.
- Nje reduktim i vlerave te presionit tregon nje rrjedhje ne sistem. Ne kete rast, eshte e keshillueshme te kontrollohen te gjitha lidhjet mekanike dhe pastaj ato te salduara. Pas zbulimit dhe eliminimit te rrjedhjes se duhet te perseritet test ii mbyllur.
- Testi konsiderohet positive kur trendi i presionit eshte rritur ose stabilizuar.

Standartet e testimit duhet te pershkruhen ne nje raport per te dokumentuar mbajtjen e rezultateve.

Dokumentacioni duhet te permbaje te pakten:

- Daten e zbatimit
  - Vendndodhjen dhe lokalizimin e trakut
  - Planin e projektit

- Kompania zbatuese dhe operatorët përgjegjës
- Manxher kantieri dhe pala tjetër
- Materiali i përdorur për tubacionet
- Standartet -referenca
- Diametrik jashtëm, trashësia, gjatësia e tubit
- Presioni nominal
- Koha e stabilizimit
- Presioni testit
- Temperatura e ujit
- Grafiku

#### 7.7.2.4 DEZINKEKTIMI I TUBACIONIT

Tubacioni është normalisht i dezinfektuar përmes përdorimit të tretësirave ujore me përqendrime të larta të klorit.

Përqendrimi i klorit nuk duhet të kalojë 100 ppm.

## 7.8 TUBACIONET ME SHITRESE DOPIO TE BRINJEZUAR

### 7.8.1 SPECIFIKIMET TEKNIKE

Furnizojnë për shtrirje të tubacioneve prej polietileni me densitet të lartë (HDPE.) për gruposje nëntokësore të kanalizimeve pa presion, në përputhje me DIN 16961, për profilizimin e tubacioneve ato prodhues të certifikuar për UNI EN ISO 9001:2000. Muri i profilit duhet të jetë i lëmuar brenda dhe i ngjyrosur lehtë për të lejuar një inspektim vizual të mirë ose duke përdorur kamerë, ndërsa struktura e jashtme duhet të garantojë inercinë e nevojshme për të ruajtur ngurtësinë e parashikuar të rrethit dhe duhet mbështetur nga materiali polimerik dhe mund të jetë i mbështetur nga material polimerik i ndryshëm nga PE. Tubacionet duhen zbuluar nga sipërfaqja për të parë shenimet e parashikuara nga referenca e standartit; lidhjet/bashkuesat janë kryer me anë të bashkueses polietileni special ndërtuar vazhdimisht në mandrine ose rezistencë elektrike për të realizuar bashkimin e shkrirë-elektro.

Tubacionet HDPE duhet të përputhen me EN ISO 9969, EN 13476-1, EN 13476-2, EN 13476-3 ose standarte të tjera lidhur me EN. Tubacionet duhen projektuar për një presion pune nominalë Klasa SN 8, shtypje hidrostatike prej 50 kg/cm<sup>2</sup> në 20 °C dhe për të bashkuar me lidhëse shtytëse.

Gjatësia e tubave spirale duhet të jetë në përgjithësi 100 m. Diametrik minimal i ruloneve duhet të jetë për tubat spirale i tillë që të parandalohet deformimi i tubacionit. Diametrik minimal i brendshëm i ruloneve duhet të jetë jo më pak se 24 herë të diametrit të jashtëm nominal të tubit.

Fundet/skajet e tubit duhet te taposen ose te mbulohen.

Tubat e prodhuar prej polietileni te densitetit te larte duhet te prodhohen nga polietilen i densitetit te larte duke permbajtur veten keto, antioksidante, stbilizues UV dhe pigmente te nevojshme per manufakturen e tubacioneve te zeza te ujit te pijshem. Kontraktori duhet te siguroje nje certificate te miratuar te pales se trete per te verifikuar sa me siper.

Lidhjet mekanike dhe rakorderite duhen perdorur. Bashkimet mekanike duhet te jene te tipit shtytes. Ato duhen prodhuar ne acetal-homo-polymer ose te kombinuar me adatore gunmetal. Bashkueset sigurojne sistemin nga forca ne tension dhe shtrengimin nga uji. Tippet e bashkueseve shtytese te pershtatshme do te jene prej nje kapse unazore PVC dhe elastometer nitrati ose unaze ekuivalente O.

Flesibiliteti unazor duhet verifikuar sipas metodës EN 1446 me deformimin e barabarte prej 30% te diametrit te jashtem te tubacionit (RF30 te jete i shenuar).

Rezistenca e konsumimit te materialit te perdorur duhet verifikuar sipas EN 295-3. Rezistenca minimale e shtypjes elastike ne parametrat e bashkimit pergjate spiraleve duhet te jete superior ne 1020 N kur verifikohet sipas metodës EN 1979.

Tubacionet duhet te perbehen nga bashkues ngjites ne koke te tubit (nga  $\varnothing 160$  deri  $\varnothing 500$  mm), ose te perbere ne linje prej lidsave/zgaver te integruara (nga  $\varnothing 630$  deri  $\varnothing 1200$  mm), ose me kit bashkues perbere nga nje bashkues dhe mbyllesa elastomerike qe garantojne shtrengimin e bere ne EPDM konforme standartit Europian EN 681-1, te jete i pozicionuar ne forme individuale ne gjurmen e pare te rrudhosjes se kokes se cdo tubi, ku mund te futet bashkuesi.

Tubacionet duhet te shihen ne siperfaqen e tyre per shenimin e parashikuar nga EN13476-1 (May 2007) dhe te kene si me poshte:

- Certifikimi i testit i fleksibilitetit ngurtesise unazore parashikuar nga EN13476-1 (May 2007) duke perdorur metodën e testimit pershkruar ne UNI EN 1446.
- Nzjerre nga (UNI EN ISO9001:2000) prodhuesi i certifikuar.
- Certifikimi i testit i shtrengimit hidraulik i bashkuesave parashikuar nga EN13476-1 duke perdorur metodën e testimit pershkruar ne EN1277.
- Certifikimi i testit i rezistences se konsumit gerryerjes verifikuar sipas DIN EN 295-3.
- IIP Certificate per system bashkimi.

Tubat e valezuar HDPE per kanalizime jane bere prej dy shtresave te nxjerra nga co, valezuar nga jashte per te garantuar nje nivel te larte te ngurtesimit rrethor dhe brenda i bute rreshitshem i afte per norma rrjedhje te larte.

## 7.8.2 KARAKTERISTIKAT E PERGJITHSHME

NDERTIMI: Tub i valezuar me dopio shtrese me ngjyre te zeze jashte dhe blu brenda.

APLIKIMI: Kanalizim nentokesor pa presion

REZISTENCA E NGURTESISE: 4 – 8 KN/m<sup>2</sup> matur sipas EN ISO 9969

STRUKTURA: i qendrueshem ndaj rrezeve UV me nje vit garanci ne daten e prodhimit treguar ne tubacion.

LIMITET E APLIKIMIT: -40 °C / +40 °C

GJATESIA: 6 – 12 m i gjate

AKSESORET: Bulonat e salduara / bashkueset dhe tapat

INSTALIMI: Nentokesor ne kanal.

## 7.8.3 TIPI I TESTIT DHE KONFORMITETI

### 7.8.3.1 TESTET FIZIKE:

- Norma e rrjedhes tretur – Ref. Standarti ISO 1133: 1987 Kushti 1T. Parametrat e testit: 190 °C / 5 Kg. / 10 min) ne nxjerrje dhe lende te pare te dy shtresave.
- Densiteti – Ref. Standarti ISO 1183: 1987 – (Temperatura e testit: 23° C) ne nxjerrje dhe lende te pare te dy shtresave.
- (O.I.T) – Ref. Standarti EN 728 – (Temperatura e testit: 200° C) ne nxjerrje dhe lende te pare te dy shtresave.
- Carbon Black – Ref. Standard ASTM D 1603 – (Parametrat e testit: temp. 600° C ne nitrogen) ne nxjerrje dhe lende te pare te dy shtresave.
- Oven test – Ref. Standard ISO 12091 – (Temperatura e testit: 110° C; test time: 30 min.) ne perfundim te produktit.

### 7.8.3.2 TESTET MEKANIKE:

- Testi i ndikimit – Ref. Standarti: EN 744 ne fund te produktit
- Fleksibiliteti unazor – Ref. Standarti: UNI EN 1446
- Testi (“shkarje”) test – Ref. Standarti: EN ISO 9967
- Testi i shtrengimit hidraulik – Ref. Standarti UNI EN 1277

### 7.8.3.3 TESTI I KONFORMITETIT:

- Kontrolli visual – Ref. Standarti UNI ISO 4582 par. 3 e 4
- Shenimi – ne 2 metra interval ne tub eshte shtypur shenimi gjatesor duke perdorur boje

korrekte dhe te lexueshme

- SN llogaritja – Ref. Standarti EN ISO 9969
- Dimensionet – diametri mesatar i jashtem (de), diametri mesatar brendshem (dim) – trashesia e murit 4 min./ trashesia e murit 5 - Ref. Standartit prEN 13476-1

## 7.9 TUBAT POLIETILENI TE DENSITETIT TE LARTE (HDPE)

### 7.9.1 VETITE E MATERIALIT

Materialet nga te cilet jane prodhuar tubacionet duhet te kene vetite e meposhtme:

| Material specification                                                                                               |               |                   |                         |                         |                           |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------|-------------------|-------------------------|-------------------------|---------------------------|
| Property                                                                                                             | Standard      | Unit              | PE a.d.                 | PE 100                  | PP                        |
| Density                                                                                                              | ISO 1183:1987 | g/cm <sup>3</sup> | 0,945                   | 0,96                    | 0,935                     |
| Melt flow index MFR                                                                                                  | ISO 1133      | g/10 min          | 0,45<br>(190 °C – 5 kg) | 0,25<br>(190 °C – 5 kg) | 0,3<br>(230 °C – 2,16 kg) |
| Tensile modulus                                                                                                      | ISO 178       | MPa               | 1000                    | 1200                    | 1700                      |
| Yield stress                                                                                                         | ISO 527       | MPa               | 23                      | 25                      | 30                        |
| Tensile strength                                                                                                     |               | W/m K             | 0,4                     | 0,4                     | 0,2                       |
| Coefficient of linear thermal expansion                                                                              |               | 1/K               | 17 × 10 <sup>-5</sup>   | 17 × 10 <sup>-5</sup>   | 14 × 10 <sup>-5</sup>     |
| Specific heat capacity                                                                                               |               | J/kg K            | 2500                    | 2500                    | 2000                      |
| * indicative data not utilize as specific values. For specific data you must refere to single standard in reference. |               |                   |                         |                         |                           |

Nga zhvillimet e fundit, mund te perdoret polipropilen i modulit te elasticitetit te larte i cili eshte i afte te rrise performancat e ndjeshmerise se tubacioneve ne termat e ngurtesive, te barazoje ne vlera te tilla, per te qene i afte per te reduktuar me pas peshen.

Tubat duhet te kene siperfaqe te rrumbullaket te lemuar/bute e cila nuk jep dhembesim te mjaftueshem si brejte per te shkaktuar deme.

Tubat polietileni te zi duhet te jene rezistente perhere ndaj korrozionit atmosferik dhe rrezatimit UV. Tubat duhet te permbajne si shtese karbon te zi shperndare uniformisht ne matricen polimerike, ne kete menyre keto mund te perdoren dhe depozitohen jashte pa u demtuar materiali i tubit.

### 7.9.2 SISTEMET BASHKUESE

Te gjitha tubat duhet te shoqerohen me sistemet bashkuese te nevojshme. Fundet/skajet e tubit duhet te paisen ne perputhje me rrethanat dhe te integruar direct ne tub.

#### 7.9.2.1 BASHKIM SHKRIRJE-ELEKTRO E INTEGRUAR

Bashkimi shkrirje-elektro e integruar eshte nje metodologji e zakonshme per te ngjitur me saldim



tubat dhe rakorderite. Kjo teknike bashkimi eshte shume e favorshme e thjeshte dhe e sigurve. Nje percjelles saldimi i cili eshte i future ne prize duhet te nxehet me ndihmen e nje paisje speciale saldimi me ane te te cilit jane bashkuar se bashku dy fundet e tubit (fole dhe tapa). Nga kjo teknike bashkimi e shpejte eshte e mundur per te instaluar tubacionet ne nje periudhe te shkurter deri ne 12 m tubacion me nje diameter prej 1200 mm ne tete ore pune.

Avantazhet/perparesite e bashkimit shkrire-elektro jane:

- Saldim i shpejte
- Mundesi saldimi ne kanale te ngushta
- Sadim i tubacioneve me te medha nga brenda
- Aftesia per perdorim te disa paisjeve saldimi ne te njejten kohe
- Force e larte elastike
- 100% bashkim i shtrenguar permanent
- Record saldimi te kaluar
- Eshte e mundur per te perdorur paisjen saldimi Shkrire-Electro perseri menjehere, madje dhe kur tubi eshte akoma i ftohte

Pergjithesisht folete dhe kapaket e Saldimit shkrire-Electro-Fusion jane te pergatitura gati per saldim. Pas marrjes se fletes plastike, e cila sherben si mbrojtës i zones se saldimi, ajo eshte pastruar me nje pastrues special polietileni. Lidhja e telit te saldimi duhet te jete ne maje te tubave pasi kjo lehteson saldimin e metejshem. Pastaj, duqi/spigot mund te zhvendoset ne fole. Tubi duhet verifikuar, unaza mbeshtetese brenda duhet te vendoset ne pozicion te rregullt dhe brezi elastic i jashtem eshte shtrenguar. Pershtates saldimi duhet perdreshur ne fundet e telit te saldimi. Pastaj, mund te lidhet me paisjen e saldimi.

Ne tub do te kete nje barcode, i cili perfshin te gjithe informacionin e nevojshem per saldim. Me ndihmen e nje lexuesi barcode, ky informacion mund te lexohet dhe saldimi mund te filloje. Pasi ka mbaruar saldimi, duhet respektuar nje kohe e caktuar ftohje, e cila varet nga disa faktore. Vetem pas kesaj kohe ftohje, unaza mbeshtetese brenda dhe brezi elastic i jashtem mund te shkeputen plotesisht.

Per nje shtrirje te shpejte ne kanal, eshte e mundur per te kryer nje ose me shume bashkime electro – fusion.

#### 7.9.2.2 MUNDESIRA TE TJERA BASHKIMI

Tubacionet mund te lidhen me teknika te tjera bashkimi si vijon:

- V saldim me nxjerrje tegeli

Tubat dhe rakorderite jane bashkuar me ndihmen e nje dalesi saldimi. Perjashtat e skajeve jane ngrene. Keshtu prodhohet nje tegel saldimi i cili duket si nje V. Normalisht nuk perdoret

lidhja fole-spigot. Saldimi behet sipas DVS 2207-4.

- Saldimi me nxjerrje

Tubacionet dhe/ose rakorderite qe duhet te lidhen jane bashkuar nga nje grope dhe tape. Keshtu dy fundet e tubave jane bashkuar me nje nxjerrese paisje saldimi. Metoda e bashkimit mund te kryhet Brenda dhe/ose jashte tubit. Ky bashkim eshte mjaft i pershtatshem per tubacionet me presione te uleta graviteti dhe pusetat.

Sipas DVS 2207- 4.

- Saldimi me element te nxehte ne poligon

Tubacionet dhe rakorderite bashkohen me ndihmen e nje elementi te nxehte te makines se saldimit ne poligon.

Skajet e tubacioneve dhe rakorderive jane salduar-ne poligon. Kjo lloj metode bashkimi eshte e rekomanduar vetem per tubacionet dhe rakorderite me nje trashesi muri maksimal prej 150 mm dhe me diameter nga 300 mm deri ne 2500 mm. Sipas UNI 10520 (PE80), UNI 10967 (PE100) dhe/ose DVS 2207- 1.

- Lidhja me flanaxhe

skajet e tubacioneve dhe rakorderive bashkohen me ndihmen e nje flanaxhe celiku dhe nje grope gome-gomine. Duke u varur nga tipi i flanaxhes se tubit, adaptoret jane prodhuar me tubin, ose flanaxhat jane te gatshme si montim i vecante. Kjo lloj metode bashkimi eshte shume e perdorur per aplikimin e shkarkimit nedet te hapur dhe per lidhjet e rezervuareve. Perparesia me e madhe e kesaj lidhje eshte lehtesia ne cmontim.

- Lidhja me rondele-vrime

Ky tip bashkimi eshte nder me te perhapurat per lehtesine dhe shpejtesine e zbatimit. Kjo metode gjithashtu perdor bashkimin e vrimes-gome me bokullen dukeperfshire nje gomine speciale mbyllese e cila eshte e instaluar ne fundin e spigotave te tubit ose te rakorderise, pastaj aplikohet nje material rreshqites ne siperfaqen e brendshme te gropes dhe te rondeles per te lehtesuar futjen e pjeses mashkull.

Skajet e tubave me grope dhe rondelen realizohen ne perputhje me EN 13476 dhe UNI 10968. Rondelet (mbyllesi prej gome) duhet ti qendroje standartit UNI EN 681-1.

## 7.11 DOREZIMET

### 7.11.1 TE DHENAT E TUBACIONEVE, NYJEVE DHE RAKORDERIVE

- (1) te dhenat qe vijoje te tubacioneve te propozuara, nyjeve dhe rakorderive per furnizimin me uje dhe shperndarjen, trajtimi i ujerave te zeza dhe punimet e tubacioneve te kanalizimeve duhet te paraqiten te Supervizori:
  - a) literature e prodhuesit, duke perfshire detajet e:
    - procesi i prodhimit
    - normat e presionit dhe temperatures
    - vlerat e lejueshme te terheqjes dhe te devijimit kendor te nyjeve fleksibel
    - rekomandimet per trajtimin, magazinimin, shtrirjen, bashkimin dhe reparimin
    - paisja shpuese dhe mbyllese per lidhjet e tubacioneve,
  - b) nje certificate per cdo material qe tregon emrin e prodhuesit, daten dhe vendin e prodhimit dhe qe tregon qe materiali perputhet me kerkesat e qena ne Kontrate dhe qe perfshin rezultatet e testeve te kerkuara ne perputhje me Standartet Britanike perkatese,
  - c) tre kopje te vizatimeve qe tregojne detajet e tubacioneve, nyjeve dhe rakorderive, duke perfshire materialet e perdorur dhe masen e cdo artikulli, dhe
  - d) nje certificate e inspektimit te prodhimit dhe testimit dhe firmsur nga autoriteti i inspektimit te pavarur te aprovuar.
- (2) Te dhenat, duke perfshire certifikatat e tjera se certifikatat e inspektimit duhet te paraqiten te Supervizori te pakten 14 dite para shperndarjes se pare te materialit ne Terren. Certifikatat duhet te paraqiten per cdo ngarkese te materialit te shperndare ne Terren.

---

## **7.12 TRANSPORTI, PERPUNIMI DHE MAGAZINIMI I MATERIALEVE**

### **7.12.1 TRANSPORTI, PERPUNIMI DHE MAGAZINIMI I TUBACIONEVE, NYJEVE DHE RAKORDERIVE**

- (1) Tubacionet, nyjet dhe rakorderite per punimet e tubave te kanalizimeve duhet te transportohen, perpunohen dhe magazinohen ne perputhje me rekomandimet e prodhuesit dhe ne nje menyre e cila nuk con ne demtimin apo deformimin ne tubacione, nyje dhe rakorderi ose ne kontaminimin e tubave, nyjeve dhe rakorderive.
- (2) Tubacionet, nyjet dhe rakorderite duhet te mbrohen nga demtimi dhe tubat, nyjet dhe rakorderite e demtuara nuk duhen perdorur ne punen permanente aq me teper pa u lejuar nga Supervizori. Tubacionet, nyjet dhe rakorderite duhet te sistemohen ne stiva te sigurta dhe te mbeshteten per te parandaluar levizjet duke u transportuar.
- (3) Tubacionet, nyjet dhe rakorderite HDPE, duhet te mbrohen nga ekspozimi ne kushtet qe mund te ndikojne ne material.
- (4) Bulonat dhe dadot duhet te sistemohen ne kontenier te mbyllur metalike.
- (5) Unazat bashkuese elastomerike duhet te sistemohen ne thase dhe lubrikanti per bashkimet duhet te magazinohet ne konteniere te mbyllur te shenuar per te identifikuar permbajtjen. Unazat dhe lubrikanti duhen mbrojtur nga ekspozimi ne kushtet qe mund te ndikojne ne material.
- (6) Materialet ne kuti ose ato ne kontenier te mbyllur duhen mbajtur ne ato origjinale.

### **7.12.2 PERPUNIMI I TUBACIONEVE DHE RAKORDERIVE**

- (1) Tubat dhe rakorderite e tjera me mure te holla duhen perpunuar me metoda manual ose nga perdorimi i aplikimeve ngrites ose zinxhire, kavo celiku ose hedhje kanavace e nje tipi te rekomanduar nga prodhuesi i tubit dhe rene dakord nga Supervizori; nuk duhet et perdoren mberthimet me cengel.
- (2) Fashot/Slings duhet te vendosen rrotull tubave dhe rakorderive dhe materiali mbushes duhet te sigurohet ne pikat e kontaktit ndermjet tubave e rakorderive dhe aplikimeve ngritese metalike ose fashove. Tubat dhe rakorderite nuk duhen trajtuar nepermjet fashove metalike te kaluara permes tubave.
- (3) Tubat dhe rakorderite nuk duhet te jene subject i trajtimit te vrazhde, ngarkimit me goditje ose hedhjes dhe nuk duhen rrokullisur poshte pervec nese lejohet nga Supervizori; nese repirat jane te mbushura do lejohet.

### 7.12.3 MAGAZINIMI I TUBACIONEVE

- (1) Tubacionet e tjera me mure te holla duhet te magazinohen horizontalisht te pakten 75 mm mbi toke mbi mbajtesit e drurit. Shtresat e poshtme dhe tubat jashte ne cdo shtrese duhet te sigurohen te shtrengimet per te parandaluar levizjet anash.
- (2) Tubat me vrima dhe tapa duhet te magazinohen me baze rrotacioni dhe ne nje menyre te tille qe ngarkesat te mos aplikohen ne gryka.
- (3) Lartesia e pargut te tubave me mure te holla nuk duhet te kaloje 2 m pervec rasteve te rekomanduar nga prodhuesi dhe lejuar nga Supervizori.
- (4) Tubat nuk duhen paisur me tel pergjate rruges se tubacionit vecse eshte e lejuar nga Supervizori.

### 7.12.4 TRANSPORTI I TUBACONEVE ME MURE TE HOLLE

Kur gjate transportit, tubat me mure te holle duhen mbeshtetur ne tre gomina mbuluar me mbeshtetese te formuara te tilla qe tubat te mbeshteten mbi te pakten ne nje te katern e qarkut. Tubat duhet te fiksohen ne menyre te sigurte ne pozicionin e seciles mbeshtetese nga shiritat shtrenguese. Nje mbeshtetese duhet vendosur ne mesin e pikes se gjatesise se tubit dhe dy mbeshteteset e tjera duhen vendosur ne distance san je e pesta e gjatesise se tubit nga cdo fund i tij.

### 7.12.5 PERPUNIMI DHE MAGAZINIMI I TUBACONEVE ME MURE TE HOLLE

- (1) Pasi jane perpunuar dhe magazinuar, tubat me mure te holle duhet te mbrohen nga deformimi me ane te dy traversave vidhose me fundet gomine mbushese te formuara per tu pershtatur forms se tubave. Prodhuesi i traversave duhet ti lere ne pozicion derisa te jene fiksuar traversat ne forms e mberthimit permes.
- (2) Tubat me mure te holle duhet te trajtohen nga perdorimi i dy kanavasave te perforcuara litar me gjeresi te pakten 300 mm. Pjeset e vogla duhet te hiqen nga nje ngrites dhe duhen vendosur ne nje distance sa nje e pesta e gjatesise se tubit nga cdo fund i tubit.
- (3) Tubat me mure e holle nuk duhet te behen rulone.
- (4) Tubat me mure te holle duhen magazinuar mbi mbeshtetese drurit mbushur em pelhure kerpi per te siguruar mbeshtetjen e vazhduar mbi te pakten nje te treten e perimetrit te tubit. Tubat duhet te fiksohen ne menyre te sigurte ne pozicion me pykat shtrenguese ne nje distance sa nje e pesta e gjatesise nga cdo fund i tubit.
- (5) Tubat me mure te holla nuk duhet te behen parg mbi majen e njeritjetrit.

### 7.12.6 MAGAZINIMI I VALVOLAVE

Valvolat, duke perfshire valvolat e aftesise se operimit dhe paisjet shoqeruese elektrike dhe te kontrollit duhet te magazinohen ne perputhje me rekomandimet e prodhuesit ne nje magazine e mbrojtur nga uji apo e qendrueshme nga moti.

## 7.13 QASJA ME TUBACIONET

- (1) Karrocat me rrota gome duhen siguruar per mbajtjen e aksesit brenda tubacioneve qe kalojne DN 500 per punimet e tubacioneve te kanalizimeve per te bashkuar tubacionet, riparuar bashkueset, kemishimet dhe veshjen e brendshme dhe inspektimin e tubacioneve. Personat qe do hyjne ne tubacion do te veshin kepuce te paster dhe te bute.
- (2) Ventilatorete mekanike duhet te ofrojne per te siguruar qe furnizimi me ajer adekuate eshte i pershtatshem per keto hyrje ne tubacion per inspektimin. Ventilatorete me motor duhet te paisen me nje nxjerres fleksibel ose metoda te tjera te mbajtjes paster te gazit nxjerres me hyrjen e ajrit te fresket.

## 7.14 SHTRIRJA DHE SHTRATI I TUBACIONEVE

### 7.14.1 SHTRIRJA E TUBACIONEVE

- (1) Supervizori duhet te lejohet te inspektojne kanalet, shtreterit, tubat, nyjet bashkuese, rakorderite dhe valvolat para shtrirjes se tubacionit per fillimin e punimeve te tubacioneve te kanalizimeve. Kontraktori duhet te informoje Supervizorin 24 ore para, ose nje periudhe te tille te shkurter rene dakord me Supervizorin, para fillimit te shtrirjes se tubacioneve ne cdo pjese te punes se perhereshme.
- (2) Leja e Supervizorit duhet te merret para fillimeve te shtrirjes se tubacionit ne cdo pjese te punes se perhereshme.
- (3) Kontraktori duhet te inspektojne tubacionet, nyjet, rakorderite dhe valvolat, duke perfshire kemishimet e jashtme dhe te brendshme, menjehere para dhe pas shtrirjes se tubacioneve; valvolat duhen kontrolluar per tu siguruar qe ato jane ne rregull per pune dhe jane te afta per hapje dhe mbyllje te plote. Materiali i demshem duhet hequr dhe demtimi duhet riparuar menjehere para dhe pas shtrirjes se tubacioneve; uji i pijshem duhet perdorur per larje.
- (4) Ne brendesi te tubacioneve duhet mbajtur paster dhe i lire nga uji, pislleqet, guret, mbeturinat dhe materiali i demtuar. Pervet rastit kur jane te bashkuara tubacionet, fundet e hapura duhet te taposen me nje mbylles druri ose tape ose metode tjeter rene dakord me Supervizorin.

- (5) Masat duhen ndermarre per te parandaluar notimin e tubave.
- (6) Shtrirja e tubacionit duhet te ndiqet ngushtesisht me germimin e kanalit. Gjatesite e kanalit qe sipas opinionit te Supervizorit jane te teperta nuk duhen lene hapur.
- (7) Vetem nese jejojhet nga Supervizori, tubacionet me nje pjerresi sa 1 e 20 duhet te shtrihen ne nje drejtim perpjete me bazat/zgavrat qe perballet tatepjeta.
- (8) Tubat duhet te shtrihen ne nje menyre te tille qe uji nuk do te krijojte pellg ne vende me pjerresi zero e te ceket dhe e tille qe linja dhe nivelet e tubave do te perputhen me tolerancat specifike.

#### 7.14.2 SHTRIRJA E TUBAVE ME BASHKUESA FLEKSIBEL

Shkalla e kurbes se tubave per punimet e kanalizimeve me bashkimet fleksibel qe jane per tu shtrire ne nje vije te lakuar duhet te shperndahet ne menyre te barabarte ne te gjitha bashkimet brenda seksionit te kurbezuar. Devijimi ne nje bashkim te kompletuar nuk duhet te kaloje 3° ose tre-katertat e devijimit maksimal rekomanduar nga prodhuesi cilado qe te jete me pak.

#### 7.14.3 INSTALIMI I VALVOLAVE

- (1) Pajimet e punes dhe rakorderite shoqeruese duhet te instalohen dhe fiksohen ne te njejten kohe si valvolat per veprat e tubacioneve te furnizimit me uje. Pas instalimit, valvolat duhet te jene te pastra brenda dhe jashte dhe te lihen ne nje pozicion te mbyllur.
- (2) Celesat dhe morsetat zgjatues do te fiksojne valvolat ne dhomat e valvolave nese distance vertikale ndermjet majes se aksit te valvoles dhe nivelit te tokes kalon 600 mm. Gjatesia e celesave zgjatues duhet te jete e tille qe maja e celsit zgjatues te mos jete me shume se 300 mm nen nivelin perfundimtar te tokes.

#### 7.14.4 SHTRATI I TUBACIONEVE

- (1) Siperfaqet ne te cilat tubacionet per punimet e kanalizimeve do te shtrihen duhet te pastrohen dhe objektet qe mund te demtojne tubacionet duhen larguar para shtrirjes se tubacioneve.
- (2) Fundi i kanaleve ne te cilen tubacionet do te shtrihen direkt duhet te kene forme per te mbeshtetur tubin uniformisht pergjate gjatesise se linjes; vrimat duhen cpuar per te parandaluar qendrimin e tubave ne zgaver dhe per ti lejuar tubacionet per tu bashkuar.

#### 7.14.5 PRERJA E TUBACIONEVE

- (1) Tubat per punimet e kanalizimeve duhet te priten dhe fundet duhen pergatitur ne perputhje

me rekomandimet e prodhuesit; paisje te bera per kete qellim te rekomanduara nga prodhuesi dhe rene dakord me Supervizorin duhen perdorur per prerjen e tubave.

- (2) Fundet/skajet e prerjeve te tubave duhet te jene te drejta dhe pa asnje demtim tubi ose kemishimi/veshje. Fundet e prera, duke perfshire fundet e prera te copave jot e kerkuara menjehere, duhet te shkurtohen dhe priten per tiu pershtatur tipit te bashkimit dhe ne nje menyre te tille qe unazat bashkuese elastomerike nuk duhet te demtohen nga fundi i prere.
- (3) Tubat qe kerkohen per tu prere per te formuar mylljen e gjatesise nuk duhen prere deri sa tubat e prane fqinje te jene shtrire dhe bashkuar dhe gjatesia per tu prere mund te matet me saktesi.
- (4) Leja e Supervizorit duhet te merret para se tubat e siguruar nga punedhenesi te priten. Vetem ato tuba te cilat sipas opinionit te Supervizorit jane te pershtatshme per prerje ne Terren do te priten. Te gjitha shkurtime nuk do te perdoren per punen e perhereshme nese sipas mendimit te Supervizorit kjo gje nuk eshte praktikueshme.

#### 7.14.6 SHPIMI I TUBACIONEVE

- (1) Tubat per punimet e kanalizimeve duhet te shpohen per lidhjet me diameter me te vogel duke perdorur paisje shpimi bere per kete qellim dhe nderhyje/prerje.
- (2) Damaret e bashkimeve me vidosje duhet te lyhen para montimit me dy shtresa veshje bitumi dhe do perfundoje me tre kthesa te fijeve dredhese ose te ndonje materiali tjeter te aprovuar nga Supervizori.

#### 7.14.7 BASHKIMI I TUBACIONEVE

- (1) Tubat per punimet e kanalizimeve duhet te bashkohen ne perputhje me rekomandimet e prodhuesit dhe duke perdorur paisje dhe material bashkimi te rekomanduara nga prodhuesi dhe rene dakord me Supervizorin.
- (2) Kontraktori duhet te inspektoj tubat, nyjet bashkuese, rakorderite dhe valvolat, duke perfshire veshjet e jashtme dhe te brendshme, menjehere para dhe pas bashkimit. Materiali i demshem duhet larguar e demtimi duhet riparuar menjehere si para dhe pas bashkimit; uji i pijshem duhet perdorur per larje. Siperfaqet qe jane per tu bashkuar dhe materialet bashkuese duhet te pastrohen menjehere para bashkimit.
- (3) Te gjitha bashkimet ne tubacione duhet te jene te papershkueshme nga uji.
- (4) Gjeresia e hapsirave ne bashkime duhet te jete ne perputhje me rekomandimet e prodhuesit dhe duhet arritur sipas shenimit e jashtem te tubit, duke perdorur zbulues metalik apo metoda te tjera rene dakord nga Supervizori. Pozicioni i unazave bashkuese



elastomerike duhet kontrolluar duke perdorur zbulues metalike per bashkimin.

- (5) Hapsirat e bashkimeve ne tuba duhen mbrojtur pas bashkimit me metoda te rena dakord nga Supervizori per te parandaluar pisleqet, guret ose materialet e tjera qe hyjne bashke.
- (6) Folet e bulonave ne bashkimet me flanaxhe dhe nyjet e inkorporuara ne komponentet me bulona duhet te orientohen drejt para se bulonat te shtrengohen. Permasimi i bulonave dhe dadove duhet bere ne menyre korrekte. Dhembet e bulonave duhen lubrifikuar dhe bulonat duhen shtrenguar duke perdorur madhesine korrekte te celsit. Bulonat duhet te shtrengohen ne cifte diametralisht te kundert qe punojne rreth mesit deri sa te jane shtrenduar gjitha sipas ciftit rrotullues rekomanduar nga prodhuesi.
- (7) Vrimat e bulonave ne bashkimet me flanaxhe duhet te orientohen ne menyre simetrike rreth diametrit vertikal. Unazat bashkuese elastomerike duhet te permasohen korrekt dhe nuk duhet te dale perpara ne vrimen e tubit. Unazat mund te fiksohen perkohesisht ne faqen e flanaxhes duke perdorur nje sasi minimale ngjitesi ten je tipi rekomanduar nga prodhuesi; nuk duhen perdorur perberesa apo paste bashkimi.

#### 7.14.8 BLLOQET E FUTURA DHE TE ANKORUARA

- (1) Faqet e lidhjes dhe faqet e tjera qe jane ne Kontrate, te blloqeve te betonit te futura dhe te ankoruara per punimet e kanalizimeve duhet te derdhen direkt kundrejt terrenit te pa tronditur; faqet e germimit duhet te rregullohen per te levizur materialin e nxjerre para betonizimit. Germimi i tepert dhe hapsira e punes duhet te mbushen me beton te te njejtës Grade si blloku.
- (2) Presioni i brendshem nuk duhet aplikuar ne tubacione derisa blloqet e ngulura dhe ankoruese kane arritur fortesine e shkalles se specifikuar.

#### 7.14.9 SHTRATI BETONIT, KELLEFI DHE RRETHIMI

- (1) Tubat duhet te mbeshteten ne nivelin e kerkuar nga blloqet pyke te betonit te parapergatitur Klasa C12/15 ose nga metoda te tjera te rene dakord me Supervizorin. Nje mbeshtetes duhet te vendoset ngjitur me secilin fund te cdo tubi dhe hapsira ndermjet mbeshteteseve nuk duhet te kaloje 3 m. Nje mbeshtjellje duhet vendosur ndermjet tubave dhe mbeshteteseve.
- (2) Nyjet flesibel duhet te formohen ne shtratin e betonit, ne forme kellefi dhe rrotull ne bashkuesen fleksibel ne tub. Mbushesi bashkues duhet te vendoset prane bashkuesit fleksibel ne tubacion dhe duhet te zgjatet per trashesine e plote te shtratit, kellefit dhe rrethimit.

- (3) Fletet Polietileni duhet te vendosen ne fundin e kanalit para betonizimit.
- (4) Betoni duhet te vendoset ne menyre te barabarte me gjeresine e plote te shtratit dhe me gjatesine e plote te tubit duke u betonizuar deri vetem ne nje nivel 25 mm poshte tubit dhe punuar nen tub derisa betony te perhapet nen tub. Betoni pastaj duhet te vendoset i barabarte ne dy anet e tubit ne nivelin e specifikuar.

#### 7.14.10 TOLERANCAT: TUBACIONET

Linja dhe niveli i tubacioneve per punimet e kanalizimeve duhet te jete brenda 25 mm te linjes dhe nivelit te specifikuar.

## 9 PUNIMET MEKANIKE

### 9.1 TE PERGJITHSHME

Kontraktori duhet te garantoje qe te gjitha paisjet mekanike jane te lira nga projektimi I gabuar jo adekuate, montimi apo vendosja e pa sakte, materialet me difekte apo mjeshteria, si dhe rrjedhja, thyerja apo demtim tjetër. Materialet e perdorura duhet te jene te pershtatshme per kushtet e operacionale.

Te gjitha paisjet duhet te jene te dizenuara, prodhuara dhe montuara sipas procedurave te njohura si dhe praktikave, te jene te pranueshme nga Supervizori dhe te zgjedhura per nje jetegjatesi dhe mirembajtje minimale. Pjeset individuale duhet te jene te prodhuara ne madhesi standarte per aq sa te jete e mundur, qe riparimi I ketyre pjeseve te furnizohen ne cdo kohe dhe te montohen ne terren.

Te gjitha pjeset qe nuk jane pershkruar ne specifikimet teknike te tilla si bulonat, kushinetat, tapat etj. Qe jane te nevojshme per nje instalim te plote "gati per pune", duhet te perfshihen ne tender.

Paisjet mekanike duhet te jene te reja dhe jot e perdorura ne pune ne cdo kohe para dorezimit, pervec se kur kerkohet per testet e tyre.

### 9.2 STANDARTET

Te gjitha dizenjimet, materialet dhe mjeshterite duhet te perputhen mekerkesat perkatese te:

- Autoriteteve te Republikes se Shqiperise me juridiksionin e cdo aspekti te punimeve.
- Standartet, Kodet e Praktikës dhe Rregulloret Shqiptare te aprovuara.
- Standartet, Kodet e Praktikës dhe Rregulloret perkatese nderkombetare te njohura.

***Tabela: Standartet Nderkombetare per paisjet dhe punimet mekanike***

| Date e leshimit | Subjekti                                                                                                                                                 | Standarti Nderkombetar |
|-----------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------|
|                 | <b>Celiku strukturor</b>                                                                                                                                 |                        |
| 01.11.2004      | Produktet e nxehta roll te celiqeve strukturor - Pjesa 1: Kushtet Teknike te Pergjithshme te Dorezimit                                                   | EN 10025-1             |
|                 |                                                                                                                                                          |                        |
|                 | <b>Celiku I pandryshkur</b>                                                                                                                              |                        |
| 01.06.2005      | Celiquet e pandryshkur - Pjesa 1: Lista e celiqeve te pandryshkur                                                                                        | EN 10088-1             |
|                 |                                                                                                                                                          |                        |
| Date e leshimit | Subjekti                                                                                                                                                 | Standarti Nderkombetar |
|                 |                                                                                                                                                          |                        |
|                 | <b>Giza</b>                                                                                                                                              |                        |
| 01.06.1997      | Themelimi – Sistemi I percaktimit te gizes – Simbolet dhe numrat e materialit                                                                            | EN 1560                |
| 01.06.1997      | Themelimi – Gizat gri                                                                                                                                    | EN 1561                |
| 01.07.2005      | Themelimi – Gizat grafitte sferoidale                                                                                                                    | EN 1563                |
|                 |                                                                                                                                                          |                        |
|                 | <b>Tubat e celikut dhe rakorderite</b>                                                                                                                   |                        |
| 01.01.2005      | Tubat celikut me saldim per qellime presioni – Kushtet e shperndarjes teknike - Pjesa 1: Tubat celikut jo-alloy me veti temperature dhome te specifikuar | EN 10217-1             |
| 01.12.2002      | Tubat e celikut pa tegel dhe te salduar – Dimensionet e masat per njesi gjatesie                                                                         | EN 10220               |
| 01.09.1999      | Poligoni-saldimi I rakorderive te tubave - Pjesa 1: celiku I punuar karboni per perdorim te pergjithshem dhe pa kerkesa inspektimi speciale              | EN 10253-1             |
|                 |                                                                                                                                                          |                        |
|                 | <b>Fllanxhat e celikut</b>                                                                                                                               |                        |
| 02.1972         | Fllanxhat; Qe lidhen me Dimensionet                                                                                                                      | DIN 2501               |
| 01.12.2001      | Fllanxhat dhe bashkimet e tyre – llanxhat cirkulare per tubat, valvolat, rakorderite dhe aksesoret, PN I caktuar - Pjesa 1: Fllanxhat celiku             | EN 1092-1              |
|                 |                                                                                                                                                          |                        |
|                 | <b>Tuba dhe rakorderi hekuri te punueshme</b>                                                                                                            |                        |
| 20.08.1998      | Tubat e hekurit te punueshem, rakorderite, aksesoret dhe bashkimet e tyre per aplikimet e ujit dhe gazit                                                 | ISO 2531               |
|                 |                                                                                                                                                          |                        |
|                 |                                                                                                                                                          |                        |
|                 | <b>Fllanxha gize</b>                                                                                                                                     |                        |
| 01.04.1997      | Fllanxhat dhe bashkimet e tyre - llanxhat cirkulare per tubat, valvolat, rakorderite dhe aksesoret, PN I caktuar - Pjesa 2: Fllanxhat e gizes            | EN 1092-2              |
|                 |                                                                                                                                                          |                        |
|                 | <b>Valvolat</b>                                                                                                                                          |                        |
| 01.05.1979      | Valvolat Hyrje/porte; Informacione te Pergjithshme                                                                                                       | DIN 3352-1             |
| 01.08.2004      | Valvolat Industriale – Valvolat e kontrollit prej gize                                                                                                   | EN 12334               |
|                 |                                                                                                                                                          |                        |
|                 | <b>Certifikatat e materialit</b>                                                                                                                         |                        |
| 01.10.2004      | Produktet metalike – Tipet e dokumentave te inspektimit (ekuivalente me te parat DIN 50049-3.1B)                                                         | EN 10204               |
|                 |                                                                                                                                                          |                        |

|                        |                                                                                                                                                                                                                                                                                                |                                                                                                                 |
|------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                        | <b>Saldimi</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                 |                                                                                                                 |
